



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 7 TETOR 2016**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 07. OKTOBRA 2016. GODINE**

**TETOR - OKTOBAR
2016**

Rendi i ditës

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Trepçën,
5. Votimi për emërimin e një anëtari në Komisionin për Kërkesa Pronësore,
6. Votimi i Projektligjit për investimet strategjike në Republikën e Kosovës,
7. Votimi i Propozim-rezolutës lidhur me Kodin telefonik shtetëror të Republikës së Kosovës,
8. Votimi i Propozim-rezolutës lidhur me situatën aktuale politike në pjesën veriore të Republikës së Kosovës,
9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 05/L-117 për akreditim,
10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-047 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-065 për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta,
11. Zgjedhja e 1 (një) anëtari të Këshillit Prokurorial të Kosovës,
12. Shqyrtimi i raportit për gjendjen në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës për vitin 2015,
13. Shqyrtimi i raportit të Agjencisë së Statistikave të Kosovës për vitin 2015.

Dnevni red

1. Vreme za deklarisanja van dnevnog reda,
2. Vreme za parlamentarna pitanja,
3. Usvajanje zapisnika sa prethodne sednice
4. Prvo razmatranje Nacrta zakona o Trepči,
5. Glasanje za imenovanje člana Komisije za imovinske zahteve,
6. Glasanje Nacrta zakona o strateškim investicijama u Republiku Kosova,
7. Glasanje Predloga - odluke u vezi državnog telefonskog koda Republike Kosova,
8. Glasanje Predloga - odluke u vezi aktuelne političke situacije na severu zemlje,
9. Prvo razmatranje Nacrta zakona br. 05/L-117 o akreditovanju,
10. Drugo razmatranje Nacrta zakona br. 05/L-047 o izmenama i dopunama Zakona br. 04/L-065 o autorskim i srodnim pravima,
11. Izbor člana u Tužilačkom savetu Kosova,
12. Razmatranje Izveštaja o stanju civilne službe Republike Kosova za 2015. god.,
13. Razmatranje Izveštaja rada Statističkog zavoda Kosova za 2015. god.

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

I hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 3 tetor 2016.

Para se të fillojmë me pikat e rendit të ditës, kryetari i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, zoti Ismet Beqiri e ka kërkuar fjalën.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, kërkoj që për këtë seancë të jetë e vetmja pikë e rendit të ditës - Shqyrtimi i parë i Projektligjit për “Trepçën”, që nënkupton që të hiqen pikat tjera nga rendi i ditës dhe po ashtu, mbështetur në Rregulloren gjegjësisht në nenin 84 të Rregullores së Punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, kërkoj në emër të grupit që Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për “Trepçën”, pasi të kryhet në këtë seancë, po besoj, të mbahet po sot pas përfundimit të procedurave që janë të parapara, përkatësisht shqyrtimit në komisionet e caktuara dhe kjo seancë e dytë për këtë projektligj të rëndësisë së veçantë për Kosovën dhe qytetarët e Kosovës të mbahet sot. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! E kemi një propozim, por para se të kalojmë te propozimi, t’i pyes kryetarët e grupeve parlamentare.

Kryetari i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, zoti Ismet Beqiri, kërkoi që të largohen të gjitha pikat tjera të rendit të ditës, apo vetëm pika e parë dhe e dytë, kur ta hedh në votim ta keim parasysht. Urdhëro!

ISMET BEQIRI: Zoti kryetar!

Për këtë seancë të largohen të gjitha pikat e rendit të ditës, të mbetet vetëm Shqyrtimi i Projektligjit për “Trepçën”, po e përsëris, dhe ky projektligj për “Trepçën” të shqyrtohet në leximin e dytë sot, të thirret seancë e re, dhe pastaj Kuvendi në atë seancë të re, pas leximit të dytë, është temë tjetër, mund të vendosë a duam të vazhdojmë me pikat tjera apo jo. Por, me rëndësi është që në këtë seancë të jetë vetëm kjo pikë e rendit të ditës dhe për të njëjtin projektligj të mbahet edhe seanca e dytë sot. Faleminderit!

KRYETARI: Atëherë, kemi një propozim nga Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës. Për propozimin e parë, ta keni parasysht, a ka mundësi që ta bëj qartësimin, pastaj unë do t’ia jap fjalën secilit grup parlamentar për të deklaruar dhe për të pyetur.

Do të thotë veç proceduralisht për t'i shtyrë të gjitha pikat tjera të rendit të ditës, për t'i larguar duhet votimi i thjeshtë - deklarimi i kryetarëve të grupeve parlamentare dhe votim i thjeshtë.

Për ta mbajtur sot seancën tjetër po ashtu duhet shmangia nga Rregullorja, për seancën e re po them, për seancën e dytë.

Do të thotë shkojmë me grupet parlamentare, zoti Zenun Pajaziti nga Partia Demokratike e Kosovës, për propozimin e Ismet Beqirit.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryetar!

Zoti kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Kolegë deputetë,

Meqenëse Ligji për "Trepçën" është trajtuar disa herë edhe nga deputetët, edhe nga grupet parlamentare, meqenëse po ashtu jemi të vetëdijshëm që kemi pak kohë pas nesh, mendoj që seanca e sotme ose dita e sotme të fokusohet vetëm për "Trepçën", e unë e mbështes propozimin e zotit Beqiri, kryetar i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, për shmangie nga rendi i ditë dhe sot ta kemi vetëm këtë pikë dhe po ashtu edhe për seancën e re. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Tani zoti Glauk Konjufca, nga Lëvizja "Vetëvendosje", e shpreh qëndrimin.

GLAUK KONJUFCA: Këtu nuk u dha kurrfarë arsytimi substancial se ku konsiston ngutja kaq e madhe që të dy leximet të ndodhin përbrenda një seance.

Ne i kemi vërejtjet tona për këtë projektligj dhe mendojmë që këto t'i materializojmë nëpërmjet formulimit të amendamenteve.

Në mënyrën qysh po shprehet zoti Beqiri këtu, nuk do të kemi kohë as për amendamente kualitative për t'i shtuar në leximin e dytë dhe kjo po bëhet me qëllim, duke e ditur që Qeveria ka pasur kohë deri tash dy vjet prej shqyrtimit të fundit që ta bëjë këtë projektligj ashtu siç duhet dhe ta ketë kohën e mjaftueshme që të mos bëjmë gabime për shkak të ngutjes.

Pra, ne nuk e dëgjuam ndonjë arsyetim të vlefshëm se pse nuk duhet të bëhet javën e ardhshme, për shembull. Pse duhet të bëhet sot?

Unë qysh e di, likuidimi i "Trepçës" nuk rrezikohet nëse nuk bëhet ligji deri më 2 nëntor, e pse nuk po bëka për shembull që kjo të bëhet më 15 tetor a më 16 tetor, që ky ligj të lexohen në leximin e dytë. Nuk dëgjova kurrfarë arsytimi, i cili do të ishte i pranueshëm për ne.

Na ka ndodhur shpesh në këtë mandat të kësaj Qeverie, gjashtë-shtatë herë më së paku, sa e mbaj në mend unë, që ligjet më të rëndësishme të vendit i kemi proceduar në të dy leximet përbrenda një seance në të njëjtën ditë. Kjo është skandaloze, është joserioze.

Ne nuk mund të kemi as amendamente kualitative, as kohë të mjaftueshme për t'i analizuar ku janë të nevojshme këto amendamente nëse kjo ndodh përbrenda një ore apo përbrenda dy orëve që ne ta kryejmë krejt Projektligjin për "Trepçën". Thjesht është e papranueshme.

KRYETARI: Faleminderit! E kemi tani qëndrimin tani të Listës serbe, zoti Simiq fjala për ju.

SLAVKO SIMIĆ: Hvala predsedniče!

Poštovani predsedniče Vlade,

Poštovani ministri,

Dame i gospode narodni poslanici,

Parlamentarna grupa Srpske liste ne podržava predlog Ismeta Beqirija iz prostog razloga zato što smo mi u ponedeljak predsedniče, ako se sećate, imali sednicu Predsedništva na kome smo razmatrali dnevni red za ovu plenarnu sednicu, i sigurno će se složiti sve kolege koje su članovi Predsedništva da na toj sednici nismo uvrstili Nacrt zakona o "Trepçi", tako da mislim da su prekršeni mnogi članovi Poslovnika, i sigurno da predlog gospodina Ismeta Beqirija na današnjoj sednici nećemo podržati, zato što nismo upoznati ni sa materijalom o Nacrtu zakona, a sigurno ukoliko se krše procedure i ukoliko se krše mnogi članovi Poslovnika rada Skupštine sigurno da nećemo podržati. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! E kemi qëndrimin e Listës serbe, ndërkohë në mbledhjen që e kemi mbajtur të Kryesisë së Kuvendit kemi proceduar në bazë të Rregullores së Kuvendit, e kemi pasur një debat që kolegët e Kryesisë dhe shefat e grupeve parlamentare e kanë pasur parasysht. Gjithë ajo që e kam bërë unë si kryetar i Kuvendit për arsye se ka qenë debat i gjerë nuk e ka ngritur Lista serbe fare si shqetësim, e ka ngritur Lëvizja "Vetëvendosje" dhe në këtë çështje është vepruar në bazë të Rregullores.

Nga viti 2009, tash do të vijë edhe zyrtarisht procedimi im sesi është bërë për këtë seancë plenare, sa herë deri tani po ky Kuvend ka proceduar në mënyrë të njëjtë, veç ta kemi parasysht.

Tani fjalën e ka zoti Pal Lekaj, në emër të Grupit Parlamentar Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës.

PAL LEKAJ: Faleminderit, kryetar!

Duke u bazuar në rëndësinë e "Trepçës" dhe kohën që e kemi përpara shumë të shkurtër, ne si grup parlamentar dhe si Aleancë për Ardhmërinë e Kosovës e mbështesim që sot të bëhet leximi

i parë dhe të miratohet në përgjithësi Ligji për “Trepçën” dhe lus edhe kolegët tjerë që ta japin kontributin e vet, sepse është i një rëndësie të veçantë.

Mirëpo, kërkoj nga ju që pas debatit për leximin e parë, të mbledhet me urgjencë Komisioni dhe t’i shqyrtojë amendamentet veç e veç dhe të vijmë e ta miratojmë ligjin në përgjithësi.

Prandaj, Aleanca e përkrah mendimin e zotit Beqiri dhe ne do të japim kontributin tonë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Enver Hoti, në emër të “Nismës për Kosovën”, e ka fjalën.

ENVER HOTI: Faleminderit, kryetar!

“Nisma për Kosovën” e përkrah propozimin e zotit Beqiri që kjo seancë të jetë vetëm me pikën e rendit të ditës - Projektligji për “Trepçën”, dhe po ashtu ne bëjmë thirrje që të na krijohet mundësia e duhur që amendamentet të cilat i kemi si grup parlamentar t’i paraqesim në leximin e dytë, që do të ndodhë brenda kësaj seance. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ndërkohë vetëm në dy muajt e fundit, pa futur në ndonjë tjetër, i kemi dy raste, më 10 gusht dhe më 14 shtator, procedimi i njëjtë me këtë që jemi duke e bërë sot. Në qoftë se keni nevojë, kjo është në Administratë.

Atëherë, zoti Kujtim Paqaku, nga Grupi Parlamentar “6+” e ka fjalën.

KUJTIM PAQAKU: I nderuar kryetar,
Edhe Grupi Parlamentar “6+” e përkrah propozimin e zotit Beqiri. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! I kemi dy kërkesa në të njëjtën kohë ne do të shkojmë në votimin e të dyjave, ndaras. Në rend të parë do të shkojmë në votimin e kërkesës së kryetarit të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, zotit Ismet Beqiri, që të largohen të gjitha pikat tjera të rendit të ditës, të mbetet për sot vetëm pika e rendit të ditës - Projektligji për “Trepçën”, dhe në të njëjtën kohë pastaj po sot do ta kemi seancën e dytë plenare, po ashtu për “Trepçën”, në leximin e dytë, atëherë do të votojmë në bazë të Rregullores së Kuvendit.

Kush është për, do të shkojmë me ngritje dore. Kush është kundër? Ngrini dorën kush është kundër. Faleminderit!

Administrata, ju lutem, ka ndodhur një gabim. “Për” jam unë, nënkryetar a ke votuar “për”? Kërkoj falje, faleminderit shumë Armend!

A ka abstenim? Kërkoj falje edhe një herë, ta keni parasysh Administrata, ka shpërputhje me numrat të cilët m'i jep. 75 për në qoftë se janë, 10 kundër, "Vetëvendosja" 13 që nuk kanë votuar. Sido që të jetë, prapë nuk po dalin numrat ashtu si janë, 13 të "Vetëvendosjes", që kanë qëndrimin as për, as kundër.

Unë kisha kërkuar falje edhe një herë, ndërkohë elektronika të përgatitet për arsye se nuk po punon aktualisht te unë. Nuk e di regjia, që të futemi në mënyrë elektronike, që ta heqim çdo dilemë, është më mirë, të mos kemi polarizime për çështje që janë të qarta.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Jemi te propozimi i kryetarit të Grupit Parlamentar të LDK-së. Kush është për, kundër dhe abstenim? Votojmë tash!

Kanë votuar 80 deputetë, 72 janë për, 8 kundër, nuk ka abstenim. Edhe një votë ishte për - 73 për, 8 kundër, nuk ka abstenime.

E kemi edhe një propozim tani, ndërkohë do të shkojmë po ashtu në mënyrë elektronike. Shefi i Grupit Parlamentar të Listës serbe ka kërkuar që të largohet Projektligji për "Trepçën" nga rendi i ditës.

Ju lutem, regjia dhe deputetë të përgatitemi për votim. Gjithsesi më mirë është, sepse zakonisht shkojnë dy propozimet, mos e komplikoni situatën kur nuk ka nevojë. Është shumë e lartë.

Lista serbe ka kërkuar që Projektligji për "Trepçën" të largohet sot nga rendi i ditës. Ne zakonisht kur i votojmë amendamentet, ju kujtohet - i votojmë dy, edhe pse njëra e merr shumicën absolute, megjithatë e bëjmë të njëjtën alternativë.

Ju lutem, votoni se kështu është procedura, se bëj me qejf, ta keni parasysh. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, propozimi i kryetarit të Grupit Parlamentar Listës serbe që nga seanca e sotme të largohet Projektligji për "Trepçën". Kush është për? Kush është kundër? Dhe kush është abstenon? Votojmë tash!

Kanë votuar gjithsej 92 deputetë, 84 janë kundër, 8 janë për. Atëherë janë 93 vota, 85 kanë votuar kundër, 8 për. Sido që të jetë, ta kemi një marrëveshje. Cila është vota juaj? Tani 96 janë kundër. Mundësisht regjia jua sjellë kartelat, se dy deputetë i kemi pa kartela, që të mos kemi problem.

Të nderuar deputetë,

Vendimi ishte juaji, e kemi vetëm një pikë të rendit të ditës - Shqyrtimi i parë i Projektligjit për "Trepçën"

Para se të fillojmë me shqyrtimin e Projektligjit për “Trepçën”, Kuvendi duhet të deklarohet për shmangie nga afatet procedurale të parapara me Rregulloren e Kuvendit.

Ju njoftoj se Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e përbashkët me kryetarët e grupeve parlamentare, të mbajtur më 3 tetor 2016, ka vendosur t’i propozojë Kuvendit që shqyrtimi dhe miratimi i projektligjit të bëhet me procedurë të përshpejtuar - shmangie nga afatet procedurale, të parapara me nenin 15, paragrafi 7, neni 56, paragrafi 1, në neni 57, paragrafët 3, 5, 8 dhe 9, si dhe neni 64, paragrafi 4 i Rregullores së Kuvendit, si në vijim:

Shqyrtimi i parë i Projektligjit për “Trepçën” të bëhet në seancën plenare më 7 tetor 2016. Pas miratimit në shqyrtim të parë, Komisioni Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri dhe komisionet e përhershme e shqyrtojnë Projektligjin për “Trepçën” dhe Kuvendit ia paraqesin raportet me rekomandime.

Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për “Trepçën” do të bëhet po ashtu në një seancë të re plenare, më datën 7 tetor 2016.

Komisioni Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë Tregti dhe Industri, në mbledhjen e mbajtur më 6 tetor 2016, ka propozuar që vetëm shqyrtimi i parë i Projektligjit të bëhet me procedurë të përshpejtuar - shmangie nga afatet procedurale të parapara me Rregulloren e Kuvendit.

Tani fjalën e kanë kryetarët ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, zoti Zenun Pajaziti.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e mbështet propozimin për shmangie nga rendi i ditës. Faleminderit!

KRYETARI: Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, është për. Ok-ej! Grupi Parlamentar Lëvizja “Vetëvendosje”?

GLAUK KONJUFCA: ...shmangies nga rendi i ditës.

KRYETARI: Është kundër. Grupi Parlamentar Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës?

PAL LEKA: Për!

KRYETARI: Grupi Parlamentar “Nisma” për. Lista serbe?

SLAVKO SIMIĆ: Protiv!

KRYETARI: Grupi Parlamentar “6+”, Kujtim Paqaku e ka fjalën.

KUJTIM PAQAKU: Edhe Grupi Parlamentar “6+” është për.

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Limaj, a dëshironi tash a për më vonë. Po. Përfaqësuesi i Qeverisë në qoftë se e kërkon fjalën. Nuk e ka kërkuar. Atëherë është këshillë juridike në nenin 84 të Rregullores së Kuvendit të gjithë e dimë, duhen 2/3 e deputetëve të pranishëm në mbledhjen plenare.

Të nderuar deputetë, në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për miratimin e këtij propozimi në përputhje me nenin pra 84 të kësaj Rregullore për shqyrtimin dhe miratimin e Projektligjit për “Trepçën”.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Kanë votuar 87 deputetë, 71 janë për, 16 kundër, nuk ka abstenim.

Konstatoj se Kuvendi vendosi që shqyrtimi dhe miratimi i Projektligjit për “Trepçën” të bëhet me procedurë të përshpejtuar shmangie nga afatet procedurale të parapara me Rregulloren e Kuvendit, si në vijim:

Shqyrtimi i parë i projektligjit të bëhet në seancën plenare, më 7 tetor 2016. Pas miratimit në shqyrtim të parë, Komisioni Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë Tregti dhe Industri dhe komisionet e përhershme e shqyrtojnë projektligjin për “Trepçën” dhe Kuvendit ia paraqesin raportet me rekomandime.

Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për “Trepçën” do të bëhet sot në seancën plenare, më 7 tetor 2016, menjëherë pas përfundimit të kësaj seance.

1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për “Trepçën”

Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime për miratim në parim. E ftoj kryeministrin e Republikës së Kosovës, zoti Isa Mustafa, që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe ta arsyetojë projektligjin.

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: I nderuar kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Në mbështetje nenit 65, pika 1 e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe duke marrë parasysh Ligjin nr. 05/L-009, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërmarrjet publike, i

cili përcakton se organizimi dhe strukturimi i ndërmarrjes “Trepça” duhet të rregullohet me ligj të veçantë dhe me qëllim të krijimit të infrastrukturës ligjore, e cila mundëson zhvillim të qëndrueshëm, operim të kapaciteteve, rritje të vlerës së aseteve, avancim tekniko-teknologjik, e që janë jetike për zhvillimin e Kosovës dhe për mirëqenie sociale të punëtorëve, prandaj, edhe janë në interes të përgjithshëm publik, kam kënaqësinë që para jush të paraqes për shqyrtim dhe miratim Projektligjin për “Trepçën”.

Projektligji për “Trepçën”, të cilin sot po prezantoj, është një ligj i rëndësishëm i veçantë për Kosovën, sepse “Trepça” paraqet një sinonim të zhvillimit, por po ashtu të sakrificës dhe të flijimit për Kosovën. Me këtë projektligj synojmë ta hapim të ardhmen e “Trepçës”, e assesi ta rikthejmë të kaluarën e “Trepçës”.

Për përgatitjen e këtij ligji janë shfrytëzuar përvojat nga vendet dhe rastet e ndryshme për të gjetur një zgjidhje, e cila ndihmon zhvillimin ekonomik, e cila respekton kriteret e ekonomisë së tregut dhe e cila mbron interesat e punonjësve, përkatësisht minatorëve të “Trepçës”.

Ligji përcakton qartë se resurset minerale janë pronë e Republikës së Kosovës, prandaj me këtë ligj prona e “Trepçës” është dhe mbetet pronë e Kosovës. Ndërkaq, shfrytëzimi i resurseve minerale bëhet në bazë të licencës për hulumtim dhe zhvillim, të lëshuar në përputhje me ligjet e Republikës së Kosovës. “Trepça” sipas këtij ligji do të organizohet si shoqëri aksionare, në të cilën aksionar kryesor do të jetë Qeveria e Republikës së Kosovës me 80% të aksioneve dhe 20% do të jenë aksione të punonjësve të “Trepçës”. Mbi këtë bazë përcaktohet e drejta në qeverisje dhe në ndarje të dividendit ndërmjet aksionarëve, proporcionalisht me pjesëmarrjen e tyre në asetet e “Trepçës”.

Në këtë rast fjala është për asetet mbitokësore, jo për rezervat minerale. Organizimi i tillë, jam i bindur, se nxit një frymë konkurruese për të rritur eficiencën në punë dhe kjo është një zgjidhje e cila ka treguar rezultate në vendet e tjera dhe e cila si risi meriton të aplikohet edhe në rastin e “Trepçës” te ne. Çështje tjetër e cila meriton të nënvizohet është se “Trepça” do të jetë një korporatë unike, me bilanc të konsoliduar, por njësitë biznesore do të kenë pavarësinë e tyre në të ardhura dhe shpenzime, prandaj edhe në identifikimin e rezultatit financiar, i cili nuk mund të bartet nga një njësi në tjetrën dhe se punëtorët, sipas kësaj, do të korrin rezultate të tyre sipas punës që bëjnë në njësitë biznesore, përfshirë edhe shpërndarjen e dividendit.

Njësitë biznesore të “Trepçës” sipas këtij projektligji janë minierat dhe flotacioni “Trepça”, Stan-Tërg, miniera dhe flotacioni Kishinicë dhe Artanë dhe miniera me flotacion Kopaonik-Leposaviq. Ligji lë mundësi të hapura që pas studimit të fizibilitetit të themelohen njësi të tjera afariste të “Trepçës”, siç janë: metalurgjia e plumbit, metalurgjia e zinkut, industria kimike, por edhe industritë e tjera, për të cilat vlerësohet se ka llogari ekonomike dhe se hapin mundësi optimale për tërheqjen e kapitalit privat, qoftë nëpërmjet partneritetit publik-privat, qoftë

nëpërmjet investimeve direkte, investimeve të përbashkëta apo edhe nëpërmjet shitjes së aksioneve.

Projektligji siguron një kujdes ligjor dhe sipas praktikave ndërkombëtare për mjedisin siguron që 20% e rentës minerare të alokohet për komunitetin në lokacionet e komunave ku ndodhen njësitë biznesore që destinohet për mjedisin, për infrastrukturën, për sport, për shëndetësi dhe për arsim.

Asetete tjera të tani ndërmarrjes shoqërore “Trepça”, të cilat nuk trajtohen me këtë ligj, do të trajtohen sipas rekomandimeve të studimit të fizibilitetit. Pretendimet e kreditorëve ndaj njësive biznesore të përcaktuara me këtë projektligj, të krijuara deri në ditën e hyrjes në fuqi, të cilat do të trajtohen nga Agjencia Kosovare e Privatizimit në cilësinë e administratorit dhe nga Dhoma e Veçantë e Gjykatës Supreme, ndërsa Qeveria do të marrë gjithë obligimet pastaj që i caktohen me ligj.

Në hartimin e këtij projektligji përveç konsultimit ministrive dhe organeve të tjera të administratës, janë zhvilluar konsultime edhe me përfaqësuesit e “Trepçës”, me përfaqësuesit e AKP-së, përfaqësues të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, përfaqësues të Fakultetit të Gjeoshkencave, ekspertë të pavarur dhe njohës të çështjeve pronësore. Gjithashtu është shfrytëzuar mbështetja profesionale e institucioneve dhe organizatave përkatëse vendëse dhe ndërkombëtare, përfshirë ekspertë ndërkombëtarë të thirrur nga Komisioni Parlamentar për Zhvillim Ekonomik.

Pastaj, janë shfrytëzuar të dhënat e gjashtë studimeve të rastit, të cilat janë drejtuar nga Komisioni parlamentar, përkatësisht nga profesor Muhamet Mustafa, nga të cilat ne kemi marrë përvojat e vendeve të tjera lidhur me rastet e ngjashme sikurse të “Trepçës”. Unë dëshiroj kësaj radhe të falënderoj Grupin punues të themeluar nga Qeveria për punën, të cilën e ka bërë dhe Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, por po ashtu edhe Kuvendin e Kosovës, dhe sidomos Komisionin për Ekonomi të Kuvendit dhe profesor Mustafën për një punë të përbashkët konsultative në të gjitha procedurat e deritanishme.

Në fund dëshiroj të them se transformimi i “Trepçës” sipas këtij ligji është në interes të të gjithëve, është në interes të zhvillimit ekonomik të vendit, është në interes të komuniteteve dhe të komunitetit në përgjithësi në vendet ku do të operojë “Trepça”, prandaj edhe ky ligj meriton përkrahjen e të gjithë neve.

Ligji ka valorizuar të gjitha kriteret ekonomike dhe kriteret ambientale, ka karakter inkluziv dhe hap perspektivë për ndërlidhje të fuqishme ekonomike si faktor i rëndësishëm i jetës së përbashkët në Kosovë. Prandaj, unë shoh arsye që të gjithë deputetët ta përkrahin këtë ligj, ta përkrahin të gjitha grupet parlamentare dhe unë ju rekomandoj që, pas shqyrtimit që do të bëhet sot, në leximin e parë dhe në leximin e dytë, ta aprovojme. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, i nderuar kryeministër! Të nderuar deputetë, pas prezantimit të projektligjit hapi debatin për diskutim në parim.

Në emër të Komisionit FunkSIONAL ftoj kryetarin e komisionit, zotin Muhamet Mustafa, ta marrë fjalën.

MUHAMET MUSTAFA: I nderuar kryetar i Kuvendit, zoti Veseli!

I nderuar kryeministër, zoti Mustafa,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë dhe qytetarë të Kosovës,

Komisioni për Zhvillim Ekonomik dhe Infrastrukturë ka mirëpritur tekstin e projektligjit, e ka trajtuar me kujdes në një debat shumë përmbajtjesor dhe ka vlerësuar se ky ligj është i një rëndësie të veçantë, ngase përkufizon pronësinë e “Trepçës”, Kosova është pronari i “Trepçës” dhe punëtorët kanë një pjesëmarrje në Trepçë, punëtorët e “Trepçës”. Hap perspektivën zhvillimore ky ligj, përcakton aspektet organizative dhe qeverisjen korporative.

Projektligji ka dhënë zgjidhje optimale për interesin publik, interesin e punëtorëve, interesin e komuniteteve minerare dhe interesin e investitorëve duke bërë “Trepçën” atraktive duke e shndërruar në një kompani atraktive për investitorë nga radhë të aksionarëve, pra edhe Qeveria në të ardhmen do të ketë mundësi të investojë në “Trepçë”, edhe punëtorët, por gjithashtu edhe sektori privat në forma të ndryshme.

Gjatë diskutimit në komision, i cili siç thashë ka qenë shumë përmbajtjesor dhe shumë konstruktiv, dhe uroj që të vazhdojmë me një përmbajtje dhe konstruktivitet të tillë. U ngritën disa çështje për t’u debatuar midis dy leximeve dhe unë mendoj se sot kemi kushte dhe çështje t’i debatojmë dhe eventualisht t’i precizojmë amendamentet. Këto janë çështjet, si bilanci i konsoliduar i gjendjes dhe i suksesit për “Trepçën” si tërësi, çështja e mbrojtjes së interesave lidhur me pronësinë për asetet e “Trepçës” në vendet e tjera, roli i Kuvendit, si dhe ka pas ide lidhur se a është ky proporcioni më i mirë i aksioneve midis punëtorëve dhe institucioneve të Kosovës, përkatësisht Qeverisë.

Komisioni me gjashtë vota për dhe një votë kundër ka miratuar në parim këtë projektligj dhe i ka rekomanduar Kuvendit për aprovim. Më lejoni të theksoj se komisioni ka qenë në mënyrë permanente i angazhuar, duke marrë parasysh qëndrimin e këtij Kuvendi dhe Ligjin për “Trepçën” dhe ne kemi angazhuar tubime, kemi organizuar konsulta me ekspertë të brendshëm, me ekspertë vendës dhe të jashtëm. Prandaj, sado që procedurat e aprovimit të këtij ligji dukentë shpejta, unë mendoj që është fryt i një pune shumë studiuese.

Më lejoni të theksoj edhe këtu se në zhvillimin e aktiviteteve të komisionit e kemi pasur përkrahjen e rezervë të kryetarit të Kuvendit, zotit Veseli, i cili ka ndikuar që të krijohen

kushtet për punën e komisionit dhe gjithashtu edhe bashkëpunimin e shkëlqyer me komisionin e Qeverisë dhe kryeministrin Mustafa. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, Profesor! Tani është radha e grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës e ka fjalën zonja Sala Berisha-Shala.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit, zoti Veseli!

Kryeministër Mustafa,

Kabinet qeveritar,

Të nderuara kolege dhe kolegë deputetë,

Të respektuar minatorë të gjigantit “Trepça” që besoj që janë duke na ndjekur në këto momente, Ju të pranishëm,

Të gjithë ju që po na ndiqni në këtë seancë nëpërmjet televizionit,

Sot po shqyrtojmë në parim Ligjin për “Trepçën”, ky draft ligj lidhet direkt me fatin e “Trepçës”. Ky ligj ka për qëllim krijimin e infrastrukturës ligjore për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik nëpërmjet hapjes së rrugës për investime, rritjen e vlerës së aseteve dhe avancimin e kapitalit tekniko-teknologjik si parakushte për rivitalizimin e “Trepçës” jetike për interesin e përgjithshëm publik, mirëqenie sociale të punëtorëve, etj.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës vlerëson se është jashtëzakonisht e rëndësishme që sektori minerar të zhvillohet, të krijohen politika të mira dhe ligje të mira, të cilat mundësojnë që ky sektor, i cili një kohë të gjatë ka qenë edhe mburrje e zhvillimit ekonomik të Kosovës dhe ka qenë ikonë gjithashtu e zhvillimit ekonomik, të vazhdojë edhe më tutje duke krijuar hapësirë për t’u zhvilluar. Andaj Partia Demokratike e Kosovës nëpërmjet grupit të saj parlamentar vlerëson se ardhja e këtij projektligji në Kuvend është një ngjarje e rëndësishme për ekonominë e Kosovës.

Resurset minerale në përgjithësi, “Trepça” në veçanti duhet të rikthehen në ikonë të zhvillimit ekonomik. Sot, nëpërmjet këtij projektligji po e diskutojmë kahun që duhet të marrin pasuritë minerale të Kosovës, ato të plumb zinkut, arit, argjendit, të njohura si kompleksi “Trepça”. Dëshiroj t’jua rikujtoj se një dekadë më parë ish-administrata ndërkombëtare e UNMIK-ut “Trepçën” e kishte konsideruar si “dinozaur” që i takon të shkuarës, por sot jemi dëshmitarë dhe është në dorën tonë nëpërmjet votës që ta themi të kundërtën dhe t’i hapim rrugë zhvillimit.

Të nderuar deputetë,

Është shkruar dhe është debatuar tash e sa vjet për fatin e “Trepçës” si gjigant i madh minerar industrial, është debatuar në këtë Kuvend disa herë fati i kësaj ndërmarrjeje, janë prononcuar ekspertë të pavarur, ekspertë të “Trepçës” dhe institucione akademike shkencore dhe emëruesi i përbashkët gjithmonë ka qenë që “Trepça” të largohet nga menaxhimi miks dhe joefikas, i paarsyeshëm nga AKP-ja.

Projektligji që e kemi në shqyrtim i hap rrugë “Trepçës” për ristrukturim dhe rivitalizim të sektorit minerar dhe jo vetëm sektorit minerar, dhe jo vetëm “Trepçës”, për t’i hapur rrugë “Trepçës” për të treguar veten si faktorë i zhvillimit ekonomik. Për t’i hapur rrugë zbutjes së madhe të papunësisë, për t’i hapur rrugë shtetit të Kosovës që të menaxhojë me pasuritë e veta ashtu siç është e obliguar nëpërmjet Kushtetutës.

Po ashtu, me rastin e transformimit të “Trepçës”, përkatësisht ristrukturimit të saj që është edhe synim i këtij projektligji, përveç që do të nisë të promovohet dhe fillon një faqe e re e zhvillimit ekonomik, në të njëjtën kohë do të hapen dyer për investitorë si vendës, ashtu edhe të jashtëm, për të cilët ka shumë nevojë ekonomia e Kosovës. Ky projektligj definon kornizën zhvillimore të sektorit minerar, siç e thashë më parë dhe jo vetëm të “Trepçës”.

Në nenin 5, paragrafi 1 në këtë projektligj thuhet se resurset minerare janë pronë e Republikës së Kosovës që është në përputhje me Kushtetutën, duke vazhduar në paragrafin dy, që është në përputhje me Ligjin për miniera dhe minerale. Tek neni 8 i projektligjit, i cili ka të bëjë me bordin mbikëqyrës dhe bordin menaxhues, si grup parlamentar kemi vërejtje, është pak sa i paqartë. Shpresoj që të qartësohet në fazën mes dy leximeve.

Neni 12, te dispozita që krijon një hapësirë për zhvillim të sektorit minerar që lidhet me vendburimet e plumb-zinkut, thuhet se “Trepça” gjatë procesit të transformimit dhe ristrukturimit me qëllim të krijimit të kushteve për zhvillimin e saj do të hap mundësi atraktive për investitorët privat brenda dhe jashtë vendit, në formën ose nëpërmjet partneritetit publiko-privat, investimet direkte private, investimet e përbashkëta, e tjerë.

Neni 13 i këtij projektligji ofron një qasje ndryshe gjer më tani, e që ka të bëjë me përgjegjësinë sociale në raport me komunitetin, ku ndodhet njësia biznesore e që lidhet me dedikim specifik për investime aty në fushën e mbrojtjes së mjedisit, infrastrukturës, arsimit e kështu me radhë. Në këtë pikë kolegët tanë deputetë nga komuniteti serb kanë ngritur shqetësime se gjoja nuk iu qasemi punëtorëve të “Trepçës”, ndërkohë që puna e rëndë nëpër zgafelle nuk njih as etni, as ngjyrimë politike, është aq kokëfortë dhe ne sot po e rregullojmë punën e tyre dhe dinjitetin e tyre po e kthejmë nëpërmjet këtij ligji.

Ky projektligj njëherë e përgjithmonë e ridefinon pronësinë e pasurive të “Trepçës”, e të gjithë pajtohemë se pronarë i vetëm është shteti, gjegjësisht Republika e Kosovës.

Në një formë apo tjetër, kjo ka qenë edhe kërkesë e niveleve të larta edhe menaxhuese të “Trepçës” shumë herë, edhe të Sindikatës së Minatorëve edhe ekspertëve, të cilët kanë punuar shumë në këtë drejtim. Dëshiroj të falënderoj edhe Komisionin Shtetëror, i cili ka punuar me një përkushtim që të na sjellë një draftligj që sot jemi duke shqyrtuar.

Pra, të nderuar deputetë të të gjitha subjekteve politike, ju ftoj të votojmë në parim këtë projektligj, sepse edhe ashtu jemi të vonuar, sepse ia kemi obligim ekonomisë së vendit, ia kemi obligim “Trepçës” së djeshme, të sotme dhe “Trepçës” së ardhme. Ju ftoj ta votojmë, ta miratojmë këtë projektligj. Ky projektligj në njëfarë forme e bën edhe demitizimin e “Trepçës” dhe e bën demitizimin e atyre që shpesh dinë të manipulojnë edhe me qytetarët atje.

Pra, të nderuar deputetë,ua kemi obligim të gjithë minatorëve të vjetër e të rinj që dhanë mund, djersë e gjak për ta zhvilluar dhe ruajtur pasurinë e vendit tonë. Patjetër, më lejoni që këtë diskutim ta mbyll me thënien e artë të minatorëve “Me fat!”.

KRYETARI: Faleminderit! Ismet Beqiri, nga Lidhja Demokratike e Kosovës, e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, kryetar!

Zoti kryeministër,

Ministra,

Kolegë deputetë,

Arsyen, rëndësinë, dobinë dhe nevojën për nxjerrjen e Projektligjit për “Trepçën” i tha pothuajse të gjitha kryeministri dhe kryetari i komisionit, po ashtu edhe një pjesë të madhe kolegia që foli para meje. Më lejoni që të them se Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës pa dyshim mbështet këtë projektligj dhe përgëzon të gjithë ata që u angazhuan, punuan dhe mundësuan që sot para nesh të kemi një Projektligj për “Trepçën”, për kombinatin tonë që simbolizon shumëçka për qytetarët dhe shtetin e Kosovës.

Pra, Qeveria, kryeministri Mustafa dhe të gjithë ata që u angazhuan, kryen dhe po kryejnë një premtim dhe obligim që kanë dhënë për këtë projektligj. Është padyshim dhe asnjëherë s’është e tepërt të thuhet se ky Projektligj për “Trepçën” është ngjarje e veçantë për qytetarët e Kosovës e veçmas për punëtorët e “Trepçës”, kur them punëtorët mendoj para se gjithash në minatorët e kombinatit “Trepça”, njerëz të cilët kanë sakrifikuar shumë, të cilët simbolizojnë punën dhe sakrificën e angazhimit të tyre për shtetin e Kosovës nëpër të gjitha etapat e shtetfillimit dhe shtetndërtimit të Republikës së Kosovës.

Të nderuar kolegë deputetë,

Nuk ka se si të mos i gëzohemi faktit që “Trepça” dhe punëtorët e saj po bëhen me projektligj dhe me ligj, pas miratimit, kuptohet me ligj, i cili u takon dhe po realizon një të drejtë të tyre që për arsye të ndryshme gjer tani nuk kanë pasur mundësi dhe po bëhet përpjekje, jemi të bindur, po bëhet zgjidhja e ankthit dhe problemit të tyre për të sotmen, por edhe për të ardhmen e tyre si punëtorë dhe të familjeve të tyre.

Pra, të nderuar kolegë deputetë, jemi shumë të bindur që asnjëherë asgjë nuk është e përkryer, edhe projektligjet asnjëherë nuk janë të përkryera, por mund të them me përgjegjësi të plotë nga

ajo që ne kemi analizuar, nga puna që është bërë, nga të gjithë ata që janë kyçur në këtë punë me një angazhim maksimal është bërë maksimumi i të mundshmes që të kemi një projektligj për mendimin tonë mjaft të mirë dhe, fare në fund, po e them që vota për Projektligjin për “Trepçën” këtë Kuvend nuk duhet ta ndajë as në etni dhe as në parti. Dhe, unë po besoj dhe dua të besoj që votimi për Projektligjin për “Trepçën” do të jetë votë e fuqishme dhe së këndejmi edhe unë shfrytëzoj rastin, sepse jam i bindur që do të mbizotërojë mendimi, edhe grupi ynë parlamentar është i bindur në këtë që minatorët e “Trepçës” do ta kenë këtë projektligj dhe edhe unë i përgëzoj dhe uroj për realizimin e një të drejte të tyre humane, njerëzore dhe ligjore. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nga lëvizja “Vetëvendosje” Visar Ymeri, përgatitet Pal Lekaj.

VISAR YMERI: Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,
Deputetë të Kuvendit,

E dimë të gjithë dhe është folur disa herë jo vetëm në Kuvend, por në përgjithësi në diskutimin publik për rëndësinë që e ka “Trepça”. Pra siç e dimë të gjithë e veçanërisht ata që e kanë një moshë të caktuar, e edhe ata që janë këtu në sallë e që e kanë përvojën e drejtpërdrejtë, e dinë që “Trepça” ka qenë një, është quajtur “kombinat” atëherë, mund ta quajmë “kompleks industrial”, në të cilin ka pasur edhe aktualisht figurojnë 27 njësi afariste, të cilat kanë kryer punë të ndryshme.

Po ky “kompleks industrial” e ka pasur një qëllim të vetëm që resurset e nxjerra në nëntokën e Kosovës jo vetëm të fisnikërohen në metale, por pastaj edhe të përpunohen në produkte finale, edhe kështu ky zinxhir industrial ka siguruar që e tërë vlera e shtuar që krijohet prej mineraleve deri te produkti final që e ka marrë herë formën e akumulatorit, herë formën e amortizatorit dhe të tjera, të baterive e kështu me radhë, të mbetet në Kosovë. Pra që ekonomia e Kosovës, qytetarët e Kosovës të punësuar në fabrika të përfitojnë nga kjo vlerë dhe jo kjo të dalë jashtë.

Kjo ka qenë ideja e “Trepçës”, natyrisht atëherë meqenëse kemi qenë koloni e Jugosllavisë dhe Serbisë një pjesë të kësaj vlere e ka marrë Jugosllavia dhe Serbia, por sidoqoftë ideja ka qenë që Kosova ta krijojë këtë vlerë dhe ta mirëmbajë këtë vlerë. Dhe, atë kohë “Trepça” i ka pasur natyrisht fazën e vetë më të mirë dikur mbi 20 mijë të punësuar. Pra, 20 mijë persona i kanë të punësuar në “Trepçë”, jo vetëm në miniera, po në tërë kompleksin “Trepça”, kompleksin industrial, nëpër forma të ndryshme dhe në vende të ndryshme të punës.

Dhe tash, e dëgjuam Isa Mustafën që tha se këtë të kaluar nuk duam ta kthejmë. Po tha, nuk po duam ta kthejmë, jo “nuk mundemi”, por “nuk duam”, sepse po duan ta shohim të ardhmen e “Trepçës”. Në këtë drejtim, pastaj natyrisht se do të flasim në këtu se cila është e ardhmja e “Trepçës”. Pra, nëse “Trepça” nuk po mundka apo nuk po u dashka të bëhet motor i zhvillimit ekonomik e industrial i Republikës së Kosovës dhe njëkohësisht punëdhënës i madh për ta zbutur

papunësinë në Kosovë, atëherë çka po duam ta bëjmë “Trepçën”, pra cila është e ardhmja, sepse po qe se e shikon ligjin, praktikisht këtu shihet e ardhmja.

A e dini cila është e ardhmja e “Trepçës”, që po e parasheh Qeveria e Republikës së Kosovës? E ardhmja e “Trepçës” është për ta shitur atë pjesë-pjesë, sikur hajni që e vjedh veturën dhe pastaj obligohet që shpejt e shpejt ta heqë qafe e ta shesë pjesë-pjesë për t’ia humbur gjurmët dhe të fitojë sa fitohet prej asaj, ashtu edhe Qeveria e Republikës së Kosovës po e trajton “Trepçën”.

Pra, “ta miratojmë sot në lexim të parë, shpejt e shpejt ta miratojmë në lexim të dytë dhe pastaj ta shesim shpejt e shpejt, ta heqim qafe, e mbase nuk na zënë”. Ky është qëndrimi i Qeverisë së Kosovës karshi “Trepçës”. Kush e ka lexuar ligjin, nëse e keni lexuar, deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, edhe nëse doni ta kuptoni, kjo është e vërteta. E tash, nuk po them që do të shitet nesër “Trepça”, po do të shitet shumë shpejt, sepse ligji e parasheh atë.

Pra, ligji e kushtëzon privatizimin e “Trepçës” nëpër forma të ndryshme, në nivel të ndryshëm dhe me shpejtësi të ndryshme. Kur lexohet ligji, kjo merret vesh: njësitë biznesore, ndërhyrja e kapitalit privat nëpër forma të ndryshme në to, jo domosdoshmërisht në nivel të “Trepçës” si shoqëri aksionare, por në nivel të njërive biznesore, e kështu me radhë. Krejt çka flitet aty është se si do të përfshihet kapitali privat në “Trepçë”, e në asnjë mënyrë se si do të zhvillohet “Trepça” si ndërmarrje.

Është diskutuar shumë gjatë, veçanërisht gjatë viteve të fundit, se “Trepça” duhet bërë ndërmarrje publike, kemi diskutuar edhe këtu në Kuvend, bile ka pasur një periudhë shumë e shkurtë, pra njëditore, ku të gjitha grupet parlamentare pajtoheshin që e vetmja rrugë përpara për “Trepçën” është që ta shndërrojmë atë në ndërmarrje publike dhe pastaj vendosim si shtet, si Republikë, si Kuvend, se çfarë do bëjmë me “Trepçën”. Dhe, shndërrimi i “Trepçës” në ndërmarrje publike nuk nënkupton që e parandalon ose e pengon absolutisht privatizimin e saj, por nënkupton që si ndërmarrje publike shteti e merr përsipër zhvillimin e saj, por çfarë është më me rëndësi, pronësinë dhe vendimmarrjen për të. Dhe, tash kjo gjë nuk po ndodh, tash është përdorur një metodë mashtruese, mendoj unë, për ta krijuar përshtypjen kinse po e merr Republika e Kosovës në pronësi “Trepçën”, por në fakt, nuk po e merr Republika e Kosovës. 80% të aksioneve do t’i pronësojë Qeveria e Kosovës, që nuk është fare në përputhje me Ligjin për ndërmarrjet publike, ku decidivisht thuhet që ndërmarrjet publike të Republikës së Kosovës i pronëson Republika e Kosovës, rrjedhimisht vendimin për tjetërsimin e tyre e merr Kuvendi, për “Trepçën” jo.

Pra, sot po kërkohet nga Kuvendi që të votojë një ligj, me të cilin Kuvendi e përjashton vetveten nga vendimmarrja për “Trepçën”, përveç në zgjedhjen e Bordit mbikëqyrës. Kjo është i vetmi vend, ku Kuvendi vjen në shprehje. Edhe aty, natyrisht, shkarkimi i këtij bordi mbikëqyrës bëhet

nga aksionarët, që është Qeveria 80% dhe punëtorët 20%, e jo nga Kuvendi, pra me këtë ligj përjashtohet Kuvendi.

Kuvendi sot detyrohet ta marrë një vendim për “Trepçën” për ta shndërruar atë në shoqëri aksionare, pa e ditur fare studimin e fizibilitetit, që po përmendet disa herë, e është përmendur që një vit e gjysmë, por asnjëherë kurrë nuk është publikuar, nëse është bërë çfarë rezultatesh ka arritur ai, pa e ditur fare vlerën e “Trepçës”, pa i ditur fare asetet e “Trepçës” dhe pa i ditur fare se cilat njësi biznesore, siç quhen këtu, saktësisht do t’i takojnë “Trepçës” si shoqëri aksionare.

Pra, e keni parë që thuhet “fillimisht tri minierat, pastaj eventualisht metalurgjia e zinkut, plumbit dhe industria kimike, nëse studimi i fizibilitetit e thotë këtë gjë” dhe pastaj për të tjerat “shohim”. Kush sheh? Po, nuk sheh më Kuvendi, e sheh Qeveria, në rastin më të mirë, sepse studimi i fizibilitetit bëhet nga AKP-ja, nga një kompani që e kanë pranuar në mbledhje madje, që kurrë s’kanë bërë studim të fizibilitetit për raste të tilla, e ata në fund na tregojnë se çka të bëhet me “Trepçën”. Po, kjo është e vërteta për “Trepçën”, nëse doni ta lexoni ligjin me vëmendje.

Tash, kur ta lexosh ligjin dhe gjuhën e përdorur këtu, vëren një gjë që për mua është absolutisht e papranueshme, e ajo është kjo: Ligjin nuk e ka shkruar Qeveria e Republikës së Kosovës. Qe besa, po shpresoj të paktën që e kanë kuptuar, se me shkrua jo se jo. Gjuha e përdorur këtu është gjuha që përdoret nga avokatët, juristët e korporatave “njësi biznesore”, “bordi mbikëqyrës”, “bordi menaxhues”, ose më mirë të them në anglisht, se këto përdoren në anglisht “business unit”, “supervisory board”, “managing board”... po, kjo është strukturë e korporatave e shkruar nga juristët e korporatave, që është ravijëzuar në këtë ligj. Edhe tash, a s’më tregon mua dikush, si mundet Republika e Kosovës të pranojë që një ligj për një ndërmarrje kaq të rëndësishme për ekonominë tonë ta shkruajnë korporatat?! Jo asistenca nga jashtë, si USID-i, DFID-i, e kështu me radhë, korporatat drejtpërsëdrejti! Ose, mbase ju mund të thoni, “jo, ndodh në disa shtete.” Shumë keq që po ndodhka, kjo s’duhet të ndodhë askund.

Pra, po e shihni çfarë do t’i bëni “Trepçës”? “Trepçën” po e bën gati Kosova për ta marrë të tjerët, e unë nuk e di kush janë këta të tjerët, mund të na tregojë Qeveria, por sidoqoftë “Trepça” nuk do të mbetet në pronësi të Kosovës, me këtë ligj jo. Prandaj, është e domosdoshme që një ligj që e shpëton “Trepçën” nga likuidimi i AKP-së, për të cilën të gjithë jemi dakord, duhet domosdoshmërisht ta shpëtojë “Trepçën” edhe në të ardhmen, e ajo është duke e shndërruar “Trepçën” në ndërmarrje publike sipas Ligjit për ndërmarrjet publike, madje-madje duke pasur parasysh rëndësinë strategjike, ekonomike, politike dhe të tjera, të “Trepçës”, duhet domosdoshmërisht që “Trepçën” ta trajtojmë si ndërmarrje të veçantë publike. Pra, edhe vendimmarrja për “Trepçën” të mos jetë e njëjtë për vendimmarrjen për ndërmarrjet e tjera publike të nivelit qendror, ose lokal qofshin ato.

Pra, vetëm kështu shpëtohet “Trepça”, nëse vërtet e kemi për ta shpëtuar “Trepçën”, sepse duke e shpëtuar “Trepçën” duam ta ndihmojmë ekonominë e Kosovës, a nëse kemi që ta ndihmojmë xhepin personal të kujtdo qoftë në Qeveri, ose tjetërkund jashtë këtyre institucioneve, atëherë tregoni që “Trepça” po shndërrohet në monedhë kusuritje për aspekte të tjera, për arsye të tjera, e jo për zhvillim ekonomik të Republikës së Kosovës.

Ju kisha lutur, mos përdorni këso gjuhe populliste, mashtruese, me këto lot krokodili që i dëgjova deri tash këtu, se si qenka një “ditë historike” që po e “shpëtojmë” “Trepçën” e “veçanërisht po i ndihmojmë” minatorët, sepse ky 20%-shi këtu për minatorët, së pari periudha për të cilën, ose që kërkohet me ligj që ata të jenë të punësuar është absolutisht e padrejtë, sepse përjashton një numër të madh të punëtorëve që kanë kontribuar në rritjen e “Trepçës” e që aktualisht nuk janë në listën e pagave të “Trepçës” dhe, në anën tjetër, është mashtrim për punëtorët. Nuk mendoj vërtet që keni të drejtë as morale e as ligjore ta mashtroni kaq keq një grup shoqëror të Republikës së Kosovës jashtëzakonisht të rëndësishëm në aspektin ekonomik po edhe politik, e të cilët kanë kontribuar dhe sakrifikuar shumë për këtë “Trepçë”, që ne sot po bëhemi gati ta shesim. Mos i mashtroni njerëzit, tregojuni drejt, që këto 20% të aksioneve janë mashtrim për ta, këto 20% të aksioneve janë sikur 20%-shi që u premtohej punëtorëve për t’ua privatizuar fabrikat, disa i kanë marrë, disa jo, por sidoqoftë, kurrkush “qirak” me ato para nuk u bë, e s’do bëhen as minatorët. Prandaj, këtu po u flas drejtpërsëdrejti atyre, sepse vërtet këtu përpara s’po kam as kujt t’i flas, që ky është mashtrim edhe mos e blini këtë mashtrim. Kjo është ofertë që t’ua blejnë vullnetin tuaj, si...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Regjia, mos ua ndal fjalën deputetëve!

VISAR YMERI: ...po ta trajtojmë ligjin, mbase në disa nene të tij.

Te neni 12, që mendoj se është jashtëzakonisht problematik. Pra, neni 12, prapë po them, për ata që e kanë lexuar ligjin, është neni i cili ravijëzon disa, katër këtu, mundësi, rrugë nëpërmjet të cilave kapitali privat synon të përfshihet në “Trepçë”, ose në njësi të caktuara biznese të saj. Edhe këtu shihet që njëra prej tyre është partneriteti publiko-privat, tjetra është investimet direkte private, e treta është investimet e përbashkëta, që nënkupton “Trepça” plus një kapital a kompani private dhe e katërta është emetimi dhe shitja e aksioneve. Pra, askund në këtë ligj nuk janë ravijëzuar, sanksionuar, obligimet që shteti i ka karshi “Trepçës”, apo jo?! Përveç, në kontrollin përmbi Bordin mbikëqyrës të “Trepçës”, askund nuk flitet se si paraja publike e Kosovës ose format e kredimarrjes nga “Trepça” si ndërmarrje, si kompani, të përdoren për investim dhe revitalizim të “Trepçës”, gjithkund është vetëm kapitali privat.

U përmendën këtu, është e vërtetë, pesë studime që janë bërë nga ekspertë të ndryshëm, të rasteve të ndryshme, të vlerësimit e që janë bërë në kuadër, ose me kërkesë të Komisionit për Zhvillim Ekonomik. Edhe aty mendoj që njëri prej tyre është jashtëzakonisht i rëndësishëm. Rasti i Zelandës së Re, në të cilën shihet qartë se çfarëdo iniciative, nisme, që është ndërmarrë aty, e partneritetit publiko-privat nëpër forma të tjera ka rezultuar në fund me përfitim 100% privat, në rastet e minierave dhe trajtimit të resurseve minerale dhe përpunimit të tyre, sepse këtu u tha dhe është e vërtetë që është një fjali këtu në ligj, që resurset minerare mbeten pronë e Republikës së Kosovës, edhe Isa Mustafa e tha këtë si një arritje të madhe. Kjo është parim kushtetues. Natyrisht, se ligji s'ka mundur ta ndryshojë këtë, këtu nuk po ndryshon kurrgjë karshi kësaj, mirëpo kjo pronësi formale që e ka Republika e Kosovës, natyrisht mund të koncesionohet, apo jo? Kjo nuk do të thotë që ndërrohet titullari i pronës, mirëpo koncesionohet, jepet licenca, që e ka aktualisht "Trepça" për shfrytëzimin e tyre, një kompanie private dhe ajo vazhdon me shfrytëzimin dhe pastaj paguan tantiemat, të cilat, ne e dimë të gjithë, janë minimale për resurset minerale që nxirren në Kosovë. Pra, kjo nuk është kurrfarë sigurie që "Trepça" do të shndërrohet në një ndërmarrje që do t'i kontribuojë zhvillimit ekonomik të Republikës së Kosovës, natyrisht, jo në potencialin që e ka dhe të cilin do të duhej ta kishte.

Pra, askund nuk ka mundësi që së pari Qeveria e Republikës së Kosovës ta marrë përsipër investimin në "Trepçë", të paktën në ligj nuk thuhet, e dyta, që "Trepça" nëpërmjet kredive, qoftë në teknologji apo kredive financiare, që i merr si ndërmarrje, të investojë, ta revitalizojë dhe ta zhvillojë veten. E treta, format e tjera të financimit, të cilat nuk janë në shitje të pronësisë, pra emetimi i letrave me vlerë të bonëve të korporatës në këtë rast, e jo të aksioneve që nënkupton shitje të pronësisë.

Kjo është arsyeja pse Lëvizja "Vetëvendosje" këtë ligj e ka shikuar me vërejtje të mëdha. Në komision kur kemi folur, natyrisht se diskutimi ka qenë që të gjitha këto çështje që janë ngritur aty, pra edhe nga kryetari i komisionit, profesor Mustafa, edhe nga ministri Blerand Stavileci, që janë të amendamentueshme, çështje që duhet t'i diskutojmë dhe pastaj të vendosim së bashku, se cilat po i përfshijmë. Dhe, aty ka qenë ideja që të premtën ta kalojmë në lexim të parë ligjin, të hënën ta bëjmë dëgjimin publik, pas dëgjimit publik mbledhjen e komisionit, e pas komisionit ta bëjmë leximin e dytë. Tash, kjo krejt ka ndryshuar! Kjo i bie, faktikisht, që Qeveria e Republikës së Kosovës dhe dy grupet parlamentare që e kërkuan këtë përsheptim të procedurave nuk po duan ta amendamentojnë ligjin, por po duan ta mbajnë ligjin në formën, në të cilën është. E kështu i paamendamentuar, natyrisht, se ky ligj nuk është i mirë, edhe meqenëse nuk është i mirë, Lëvizja "Vetëvendosje" do të abstenojë në lexim të parë. Ne e kemi pasur qëndrimin e ndryshëm para se të fillojë seanca, kemi dashur që ta votojmë në parim për dhe pastaj ta amendamentojmë ligjin në procedurë të rregullt, mirëpo kjo u pamundësua nga Kuvendi dhe rrjedhimisht, kjo neve na pamundëson ta votojmë këtë ligj për.

Pra Lëvizja “Vetëvendosje” do të abstenojë për shkak të kësaj arsyeje, sepse nuk po doni që ky ligj as të diskutohet e as të ndryshohet për të mirën e Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Për hir të korrektësisë, kjo është shumë ditë e rëndësishme për “Trepçën”. Pavarësisht, mirë do të ishte që të gjitha grupet parlamentare ta kenë qëndrimin e vet institucional, të japin kontributin edhe me vërejtje, me sugjerime dhe me ndryshim të projektligjit. Por, sido që të jetë, unë edhe më herët e mora ndërkohë nga administrata, është Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese, të cilin profesor Sabri Hamiti e ka dërguar dhe kemi një vendim shumë të qartë. Në qoftë se do të kemi mosvotim, praktikisht konsiderohet se nuk marrin pjesë fare në seancë. U them deputetëve, nuk bëhet asgjë tragjike, vetëm mëditjet largohen.

Kështu, tani nga Lista serbe, zoti Slavko Simiq e ka fjalën. Përgatitet zoti Pal Lekaj. Kërkoj falje, zoti Pal Lekaj, për shkak të radhitjes së fuqisë parlamentare.

SLAVKO SIMIĆ: Hvala predsedniče!

Poštovani uvaženi predsedniče Vlade,

Poštovani Vladin kabinetu,

Uvaženi narodni poslanici,

Poštovani građani,

Odgovornost i obaveza mi je da danas ovde u Parlamentu govorim u ime 3 hiljade radnika “Trepče”. Odgovornost i obaveza mi je da danas ovde u Parlamentu govorim i u ime celokupne srpske zajednice koja živi na Kosovu, a naravno i odgovornost i obaveza mi je da govorim i u ime Parlamentarne grupe Srpske Liste i da prenesem naš zajednički stav, kada je u pitanju predloženi nacrt zakona o “Trepči”, koji ste danas pod hitnom postupku uvrstili ovde na dnevnom redu.

Naime, celokupna srpska zajednica koja živi na Kosovu kao i mi parlamentarni predstavnici Srpske Liste, duboko smo uvereni da će predloženi nacrt zakona o “Trepči” u čijoj izradi nacrta nije učestvovao nijedan ekspertski tim srpske zajednice, dakle ugroziti u velikoj meri ekzistencijalni opstanak radnika “Trepče”, i time praktično ugroziti većinski srpsko stanovništvo, koja živi u opštinama gde se nalaze najveća nalazišta ruda i minerala, opštine u kojima se nalazi najveća prateća infrastruktura, brojni objekti od javnog interesa i stambene jedinice, koje su građene na zemljištu ovog ogromnog ekonomskog giganta.

Zato smatramo da rešenje imovinsko-pravnog statusa Kombinata “Trepča”, koja u budućnosti treba da predstavlja motor ekonomskog razvoja svih naših opština, koje na teritoriji Kosova i svih naših zajednica koje žive na Kosovu. Treba tražiti isključivo u dogovoru i konsultaciji sa menadžmentom “Trepče”, treba tražiti u dogovoru i konsultaciji isključivo sa predstavnicima srpske zajednice, odnosno sa lokalnim samoupravama na čijim teritorijama se nalazi najveći kapacitet kombinata “Trepče”, takođe naravno treba tražiti u dogovoru i konsultaciji sa lokalnim

i međunarodnim ekspertima i uz obavezno učešće delegiranih predstavnika Srpske Liste u Parlamentu i u Vladi, jer samo takvim pristupom možemo pronaći održivo rešenje za Kombinat “Trepča”, i na taj način možemo ostvariti cilj ekonomski stabilnog razvoja svih zajednica, a samim tim sigurno da možemo ostvariti i održivu političku stabilnost.

Srpska Lista je u Parlamentu i u Vladi uvek bila spremna da podrži svaki zakon koji ima zajedničku i konstruktivnu pravnu osnovu. Sigurno da smo od konstituisanja Skupštine i od formiranja Vlade bili jedan od najpouzdanijih partnera građanima koji žive na Kosovu i zajednicama, koje žive na Kosovu, i uvek smo insistirali da se svaki problem reši isključivo dijalogom. Međutim, današnji predloženi nacrt zakona, koji je uvršten pod hitnoj proceduri na razmatranje i glasanje o “Trepči”, dakle Nacrt zakon o “Trepči”, za nas kao i za srpsku zajednicu je neprihvatljiv, i mi kao parlamentarna grupa insistiramo da se pitanje “Trepče” reši kroz dijalog, a ne usvajanjem zakona, koji ima jednostranu pravnu osnovu.

Poštovani predstavnici Vlade,

Poštovani Vladin kabinetu,

Poštovani narodni poslanici,

Želeo bih da vam pošaljem samo dobronamernu poruku i dobronamerni zahtev 3 hiljade radnika “Trepče”, želeo bih da vam pošaljem i dobronamernu poruku i dobronamerni zahtev celokupne srpske zajednice koja živi na Kosovu, koja zahteva da se nacrt zakona o “Trepči” isključi iz procedure glasanja, i mi kao parlamentarna grupa podržavamo takav dobronamerni zahtev i sada, gospodine predsedniče, kao parlamentarna grupa imamo konkretan predlog, dakle predlog da se ova tačka isključi iz današnje procedure razmatranja i današnje procedura glasanja, a sve poslanike pozivam da glasaju i da podrže naš predlog. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Pal, para se të ta jap fjalën, ne kemi votuar njëherë, nuk mund ta qesim edhe një herë në votim. Pal Lekaj e ka fjalën në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës.

PAL LEKAJ: I nderuar kryetar i Parlamentit,

I nderuar kryeministër,

Ministra,

Zëvendëskryeministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Qytetarë të Kosovës,

Medie,

“Trepça” të punojë, Qeveria tutje të mos gabojë!

E kam titulluar kështu këtë fjalim timin, në emër të grupit, meqë kam parë që çfarëdo iniciative që të përmirësojë ndërmarrjet publike në Kosovë nuk janë bërë në interes të zhvillimit, në interes të punëtorëve, në interes të atyre që kanë nevojë, siç janë qytetarët, por kjo ka ndodhur për

interesa të ngushta, edhe të Qeverisë, edhe të individëve. Prandaj, të mos u bie kështu, në atë kuptimin befas, ky titull imi.

Është e vërtetë se sa i përket “Trepçës” për mua është një ditë e mirë, për qytetarët e Kosovës, për qytetarët e Mitrovicës, për punëtorët që mund t’i quaj “luanë”, mund t’i quajmë “heronj”, mund t’i quajmë... në kuptimin më të mirë të mundshëm, sepse “Trepça” është sinonim i së mirës, është sinonim i rezistencës, është sinonim i zhvillimit të Kosovës. “Trepça” është sinonim i ndërtimit të shtetit dhe ky thesar i çmuar duhet të trajtohet ashtu siç e meriton, e jo sikur deri më tani, që me të vërtetë ky gjigant ka mbetur në mëshirën e askujt, por sot jemi në vijë të mirë që t’i japim kahe edhe rëndësinë e veçantë të trajtimit që shkon në favor edhe të zhvillimit dhe do ta bartë barrën kryesore të zhvillimit ekonomik të Kosovës.

Këtu po e shoh edhe kryetarin e Mitrovicës, Agim Bahtirin, që e përshëndes dhe i themi që me të vërtetë sot është një ngjarje e mirë edhe për Mitrovicën, edhe për qytetarët, por edhe për punëtorët. Ajo që mund të them, është e vërtetë që ligji mund të ketë dallime, nenet mund të mos pranohen dhe ne do të japim kontributin tonë, që e kemi anëtarin e komisionit, i cili është përgjegjës dhe do të japim amendamente që shkojnë në favor të përmirësimit të neneve dhe këtij ligji që të marrë formën çfarë duhet, por jo që të miratohet edhe në këtë mënyrë çfarë është.

E them këtë, sepse është mirë që aksionar është 80% Qeveria, është mirë që 20% e keni paraparë të jenë aksionarë punëtorët, por ajo që s’do të pajtoheshia është kur kthehen të mirat për punëtorët të mos fokusohemi në atë periudhën 36-mujore, por ky trajtim i të gjithë punëtorëve të bëhet barabar, të pranohet djersja e atyre që kanë punuar dhe janë themelues të “Trepçës”, që ndoshta disa prej tyre sot nuk ekzistojnë më, por ata që janë me të vërtetë të marrin atë që duhet, duke filluar nga viti 1989. Përndryshe, ne kemi bërë gabim dhe ne nuk do t’i trajtojmë ashtu siç duhet. Në këtë mënyrë, po ashtu vërejtja jonë si grup parlamentar është që të mos i lehet e tërë fuqia Qeverisë, por disi të marrë përgjegjësinë edhe Parlamenti i Republikës së Kosovës.

Në këtë mënyrë, nuk e them se ju shpejt do të shkoni si Qeveri, por vijnë qeveri të tjera, që me të vërtetë Parlamenti duhet ta ketë fuqinë e vet, që të mos lejojë që dikush të kontrabandojë apo ta marrë për interesa të ngushta.

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës do ta japë kontributin e vet si çdo herë që e ka dhënë për të mirën e vendit dhe çdoherë, do të jemi mbështetës të të mirave të qytetarëve dhe asnjëherë nuk do ta politizojmë çështjen, pa marrë parasysh në çfarë pozita jemi, por synimi ynë, edhe si deputetë të zgjedhur, edhe si parti politike, do të jetë që të kontribuojmë në të mirën dhe zhvillimin e vendit.

Prandaj, ky është synimi ynë, ky është trajtimi i tretë, që sot duhet t’i bëhet nga të gjithë deputetët dhe në këtë drejtim nuk do të hezitojmë që të mbështesim që ky ligj të jetë në të mirën

e vendit, në të mirën e “Trepçës”, në të mirën e zhvillimit ekonomik dhe më nuk do t’i bëjë dëm askujt, as Listës serbe, as veriut. Ajo që do të jetë, do të jetë si tërësi që kudo jetojnë qytetarët e Kosovës, si në veri ashtu edhe në jug, do të trajtohen barabar dhe do të jetë në të mirën e tyre.

Këtu po e them se nuk do të hezitojmë që këtë ligj ta votojmë pro si Grup Parlamentar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Fatmir Limaj, nga “Nisma për Kosovën”, e ka fjalën dhe ndërkohë profesori Muhamet Mustafa, e merr fjalën, ose edhe Besim Beqaj.

FATMIR LIMAJ: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Së pari besoj se të gjithë që jemi këtu në sallë pajtohemi me një fakt që, nëse e krahasojmë një tentativë para dhjetë muajve për të miratuar një ligj për Trepçën dhe duke e krahasuar me këtë projekt-propozim të Qeverisë tani, është një dallim i madh.

Dhjetë muaj më parë, duke iu falënderuar angazhimit të opozitës, ishte që të mos lejohet një variant i tillë i miratimit të një projektligji të tillë, ku praktikisht Kosova do të hiqte dorë nga pronësia e “Trepçës”.

Kjo tregon edhe një herë se, nëse kritikën e drejtë në interes të vendit të qarta, merren drejt e seriozisht, aty s’humb askush, por fiton vendi.

Si rezultat i atij kundërshtimi para dhjetë muajve shihet qartë se Qeveria e Kosovës ka negociuar, ka biseduar dhe e ka trajtuar këtë problem dhe ka ardhur me një projekt-ligj ndryshe, shumë më ndryshe nga ai që ka qenë para dhjetë muajve.

Një projektligj i cili meriton ta marrë mbështetjen tonë parimor dhe ne sot deklarojmë se parimisht e mbështesim këtë projektligj, siç i mbështetëm iniciativat ose propozimet e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, por përsëri edhe këtu kërkohet bashkëpunim.

Pra, jemi duke folur për një temë nacionale, “Trepça” e pasuria e Kosovës nuk është e një regjioni, nuk është e një qeverie me një mandat, nuk është e një parlamenti me një mandat, por është pasuri e Kosovës dhe si e tillë duhet të krijohen hapësira që të merren shumë seriozisht vërejtjet e secilit grup parlamentar dhe unë propozoj që në këtë hapësirë të leximit të dytë të jepet kohë e mjaftueshme që vërejtjet, të cilat i kanë grupet parlamentare dhe amendamentet të cilët donë ata t’i propozojnë, të trajtohen mirë nga të gjitha grupet parlamentare, dhe jo mbi baza partiake, por mbi bazë të interesit nacional dhe të përmirësimit të gabimeve, lëshimit, dualizmit, të hiqen gjërat e panevojshme nga ky projektligj.

Mirëpo, duke u nisur me energji pozitive, edhe nisja është kjo dhe unë kërkoj nga të gjithë ne sot t'i japim parimisht mbështetjen këtij ligji të leximit të parë për t'i hapur mundësi të shkojë menjëherë dhe sa më shpejt në leximin e dytë dhe të merren vërejtjet e amendamentet e grupeve parlamentare.

Natyrisht ne mund të themi po pse kjo është pritur deri më sot? Është e vërtetë ka pasur kohë të mjaftueshme të trajtohet, të rregullohet dhe të mbyllet kjo çështje. Pse është dashur sot të vijë një seancë në orën tre dhe të kryhet deri në ora gjashtë, por kjo fatkeqësisht këtu është krijuar një logjikë e punës këtu dhe gjithmonë gjërat e rëndësishme ruhen për sekondën e fundit dhe atëherë kur thuhet – s'kemi kohë! Ka pasur kohë të mjaftueshme të trajtohet edhe më mirë.

E tash, jemi këtu ku jemi. Ajo që ne e kemi të paqartë në projekt-ligj, besoj se do të kemi amendamente në leximin e dytë, është çështja e aseteve. Ne kërkojmë që saktësisht në këtë ligj të përfshihen asetet e “Trepçës”, cilat janë? Ose të renditen një nga një, pasuria e “Trepçës”, ose të thuhet - të gjitha asetet që i ka pasur ish-ndërmarrja “Trepça” kalojnë në këtë ndërmarrje, praktikisht të re, të gjitha.

Pastaj, të thuhet, për shembull, sepse ka fjalë që “Trepça” ka asete të jashtme, të brendshme dhe, të saktësohen ato, të dihen çka bëhet me ato asete, ku janë ato asete.

Pres që në këtë ligj të futet edhe kjo, në projektligj e pastaj i takon bordit menaxhues atje dhe ai t'i listojë me emër, me vend, me vlerë dhe me të gjitha ato që duhet t'i ketë. Nuk është punë e Parlamentit, por në fakt, ne mund të themi: të gjitha asetet të cilat kanë qenë në “Trepçë” të zënë vend, ose të kalojnë në pronësinë e “Trepçës”.

Shikoni, këtu po krijohet një shoqëri aksionare, s'ka dilemë, nuk është ndërmarrje publike, po krijohet shoqëri aksionare. Por një lidhje, një lidhje për t'i hequr dyshimet dhe dilemat, një lidhje e pronësisë, se në fund të fundit Qeveria e Kosovës është e Kosovës, Qeveria e Kosovës del prej Kuvendit të Kosovës, Qeveria e Kosovës është mbrojtëse e interesave të Kosovës dhe natyrisht se është aksionar ose përfaqësues i Kosovës në aksionet e ndërmarrjes, por një lidhje me Parlamentin, gjejeni rrugën ju atje në Komision dhe ta bëni një lidhje me Parlamentin. Leni përgjegjësinë Parlamentin, gjene një rrugë. Është më mirë edhe për Qeverinë, është më mirë për Parlamentin, është më mirë për të gjithë neve. S'ka nevojë Qeveria të ketë ndonjë presion që mund t'i bëhet. Pra, gjene një lidhje me Parlamentin. Dhe mund të gjendet me vullnet kjo lidhje me Parlamentin, mund të lidhet nën kontrollin e Parlamentit.

Çështja e punëtorëve. Shikoni, vërtet po flasim për minatorët e '89-tës. Saktësisht po flasim për minatorët e '89-tës dhe si të flasim për “Trepçën” të gjithëve na shkon mendja te minatorët e '89-tës, edhe ato të Kishnicës dhe në të gjitha minierat e Kosovës në '89-tën. Një pjesë e madhe e

tyre fatkeqësisht nuk janë më në jetë, ka prej tyre të janë. Dhe, të saktësohet - për minatorët e “Trepçës” ‘88, ‘89 të jenë brenda këtij 20%-shit.

Te çështja e punës. Edhe kjo është mirë të saktësohet në ligj, 3 vjet stazh pune. Çka nëse të tjerët i bëjnë nesër 3 vjet, çka bëhet me ata punëtorë, nga sot dhe nesër i bëjnë 3 vjet. A duhet edhe ata pastaj të bëhen aksionarë apo jo? Kjo do qartësim. A duhet të bëhet a s’duhet të bëhet, nuk e di. Por, qartësim duhet të ketë, për të mos lënë dilema, sepse sot mund të punësohet një njeri në “Trepçë” dhe pas tre vjetësh të kërkojë aksione. Me këtë ligj nuk është e qartë, ose të thotë - jo. Te saktësohet, jo deri tani, nga ky moment 3 vjet të kaluara dhe përmbyllet si çështje pa pasur dilemë nesër shteti telashe me ta.

Prandaj, unë po them kështu. Le të shërbejë ky moment i rëndësishëm, për mendimin tim, shumë i rëndësishëm për ekonominë e Kosovës, për të ardhmen e vendit tonë, le të shërbejë rasti i “Trepçës” si simbolikë, si simbol i yni i krenarisë, simbol i yni i krenarisë, të pavarësisë, dinjitetit, po edhe të shpresës sonë për rifillimin e ndërtimit dhe fuqizimit të këtij vendi, le të shërbejë që sot të gjitha grupet parlamentare të ulen dhe seriozisht, jo mbi baza partiake, jo pse po flet “Vetëvendosje” e s’duam ta dëgjojmë, jo ashtu. Ose jo pse po bëhemi ne bashkë kundër komunitetit serb, jo edhe ashtu, por të ulen të gjithë bashkë dhe ta plotësojnë këtë projektligj me ndonjë amendament të domosdoshëm për çka folëm.

Për shembull, unë e pashë nenin 12, më duket Visari e tha. Unë s’e shoh hiq të nevojshëm neni 12 të jetë në këtë ligj. Është çështje e bordit, është çështje e menaxhimit atje. Pse duhet të jetë aty me 50%, 30% dhe vinë aksionarët privatë, ne nuk e trajtojmë këtë çështje dhe kjo nëse vjen deri aty atëherë të flasë Kuvendi. Pse tash? Pse sot ne të flasim dhe të prejudikojmë çfarë do të bëhet, a do të vijë biznesi privat apo s’do të vijë. Ajo vjen me kohë. Është menaxhmenti që do të vijë nesër të na thotë dhe të na i tregojë pasqyrat financiare, rritjen dhe fuqizimin si po shkon “Trepça”.

Kosova ka nevojë për investime direkte. Kosova ka nevojë për investitorë, Kosova ka nevojë për ringritjen ekonomike dhe Kosova ka nevojë ta ngrejë në këmbë “Trepçën”, dhe në emër të kësaj ju ftoj që ne pas pauze, në leximin e dytë, ky projektligj, me plotësimin e amendamenteve, të marrë votën e të gjithë neve si deputetë të Parlamentit të Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ndërkohë fjalën e ka profesori Sabri Hamiti, nënkryetar i Kuvendit. Le të bëhet gati Besim Beqaj, pastaj profesori Muhamet Mustafa.

SABRI HAMITI: Faleminderit, zoti kryetar!
Zoti kryeministër dhe ministra,
Kolegë deputetë,

U tha edhe para meje dhe unë mendoj se pa marrë parasysh që është caktuar leximi i parë dhe i dytë sot, me vullnetin e vërtetë të gjithë atyre që e kanë lexuar mirë këtë ligj, qoftë për dy ditë, duhet të mblidhen amendamentimet dhe kjo s'ka të bëjë me kohën. Koha jonë është prej tash deri në 24 dhe kufizime s'duhet të ketë.

E dyta. Për të qenë vetë konkret, pa bërë thirrje retorike që ta kryejnë deputetët punën e tyre që e kanë me amendamentimin e ligjeve, të gjithëve, pa marrë parasysh, se s'është punë veç edhe e grupeve parlamentare, por edhe deputetët individualisht kanë të drejtë të bëjnë amendamente dhe nëse janë të mira, janë të plotfuqishme dhe pranohen njësoj.

Unë po e shfrytëzoj të drejtën time, të bëhem krejt konkret, duke ditur që ky ligj do të ketë sot dy leximet, të theksoj atë që propozoj. Kjo ka të bëjë me përgjegjësitë e Kuvendit rreth "Trepçës" së ardhshme, që duhet të jenë të sanksionuara brenda ligjit, aq më tepër nëse aksionari kryesor është Qeveria e Republikës së Kosovës që i bie 80%.

Pra, unë propozoj që neni 8, paragrafi 9, që e keni në tekst në faqen 10, të duket kështu:

"Lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me themelimin, transformimin dhe shuarjen e njësive biznesore ose investimet, në projektet e tjera, Bordi mbikëqyrës duhet të marrë pëlqimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës si aksionari kryesor, i cili pëlqim miratohet në Kuvendin e Republikës së Kosovës". Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! E ftoj zotin Muhamet Mustafa ta marrë fjalën, që ka punuar shumë në këtë projektligj, për çka e falënderojmë. Urdhëroni, Profesor!

MUHAMET MUSTAFA: Ne kemi marrë pjesë natyrisht në debate që i ka organizuar Kuvendi dhe mund të them se nja katër "think-tank" në Kosovë kanë debatuar për këtë çështje dhe kanë dhënë kontribut shumë të rëndësishëm.

Edhe ju keni qenë vetë në atë debatin që e kemi organizuar me ekspertë ndërkombëtarë. Ata ekspertë ndërkombëtarë kanë qenë pra ndërkombëtarë, as s'kanë qenë shqiptarë as serbë, janë shtetas të vendeve të jashtme. Prandaj nuk kemi bërë ndonjë seleksionim aty që t'i përjashtojmë serbët. Ekspertët serbë kanë qenë prezentë dhe kanë qenë të ftuar, kanë marrë pjesë së paku në disa takime që ne i kemi bërë rreth "Trepçës". Kanë qenë të ftuar edhe në këtë takim që po e përmend në maj të këtij viti me ekspertë të jashtëm.

Ajo që desha unë të them këtu është se vërtet unë kisha dashur që në këtë mbledhje ta tejkalojmë retorikën politike dhe retorikën, e cila dëshiron të krijojë mjegull në këtë punë.

Ligji nuk është për ta shitur “Trepçën”. Ligji është për ta transformuar, ligji është për ta zhvilluar “Trepçën”. Nuk ka kurrfarë fshehjeje. Gjithkrah është transparente, ajo që shkruan në ligj është ekzistente, dhe ajo që s’është në ligj, mund të shpiket, por është jovalide.

Në këtë drejtim, aksionet e punëtorëve janë reale, janë pronë, do të regjistrohen në emër të punëtorëve. Janë pronë, janë titullarë prone, prandaj nuk ka improvizime.

Pra, në këtë drejtim, unë kisha apeluar që vërtet të kuptohet se ky ligj ka ardhur pas një pune studiuese dhe se nuk ka këtu kurrfarë konspiracioni, por këtu kemi të bëjmë me një korporatë moderne, me një mendim modern të zhvillimit ekonomik, ku ekziston një balancë e plotë dhe një siguri e plotë për interesin publik, ku valorizohet roli i punëtorëve, ku sigurohet përkujdesja për komunitetin dhe ku jemi të hapur pa paragjykime për investitorët. Nuk është përjashtuar Qeveria e Kosovës, nuk është përjashtuar Kuvendi i Kosovës, nuk është përjashtuar shteti i Kosovës nga investimet në “Trepçë”. Por, sa do të investojë, qysh do të investojë shteti i Kosovës, do t’i vlerësojmë me studimet e fizibilitetit dhe do të vlerësojë ky Kuvend, kur ta bie buxhetin, a është më mirë të çohen 100 milionë në investime në ndonjë kapacitet përpunues të “Trepçës” apo ndoshta kemi nevojë ta bëjmë një spital. Ky Kuvend është sovran për të vendosur për këtë. Asnjë ligj dhe as ky ligj nuk e ka përjashtuar Kuvendin e Kosovës nga vendimet e tilla.

Prandaj, Kuvendi i Kosovës, Qeveria e Kosovës, institucionet e Kosovës i kanë të gjitha mundësitë të investojnë në “Trepçë” çdo herë kur e gjejnë interesin publik të siguruar, por e kanë edhe koston benefite, e kanë koston oportune, se a dëshirojnë të investojnë në “Trepçë”, dhe këtu kemi të bëjmë me dy koncepte, a po shkojmë në konceptin e shtetëzimit, apo po shkojmë në konceptin e partneritetit publiko privat, i cili partneritet e valorizon në mënyrë më të mirë interesin publik, por edhe hap perspektivën e zhvillimit të një korporate moderne.

Prandaj, çështjet janë shumë të qarta, çështjet janë për t’u diskutuar dhe unë mendoj se ne jemi të hapur të shohim, kemi diskutuar, kemi pasur diskutime shumë konstruktive, duke përfshirë edhe kolegët e opozitës dhe ne do të jemi të gatshëm që edhe në Komision t’i diskutojmë propozimet e tyre për amendamentet, në çështje të caktuara. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ndërkohë, e merr fjalën zëvendëskryeministri i Republikës së Kosovës, zoti Hajredin Kuçi.

(Ndërhyrje)

Po, s’ta përmendi emrin Visar! Për t’i referuar çështjes, do t’i referojmë sot gjithë ditën. Unë ta jap fjalën, me dëshirën që sa më shumë të konsumojmë debatin, por le ta përfundojë zëvendëskryeministri, e pastaj t’i reago. Mirëpo, nëse do, e merr fjalën edhe përkundër rregullores, si replikë...

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit, zoti Veseli,

I nderuar kryeministër, anëtarë të Qeverisë,

Të nderuar deputetë,

Me siguri se diskutimi për “Trepçën” dhe Ligji për “Trepçën” është një prej diskutimeve më të këndshme në Kuvendin e Republikës së Kosovës, por me siguri edhe prej atyre më të kujdesshme të veprimeve që i marrim.

Të gjithë ne, që jemi të moshës mesatare, dikush pak më të vjetër e dikush më të ri, ne e shohim “Trepçën” si gjigant ekonomik për një kohë të gjatë dhe krenari kombëtare, dhe gjatë një periudhe i ka pasur të dyja, por viteve të fundit, po them nga vitet e 90-ta dhe më vonë më shumë krenari kombëtare, më pak gjigant ekonomik.

Ne sot e kemi një ligj para veti, që do të na mundësojë të ndryshojmë këtë qasje tonë dhe ta bëjmë nga një ndërmarrje që ka qenë qoftë kompleks industrial, qoftë kombinat, apo sido që e kanë quajtur, në një ndërmarrje që do të jetë profitabile në ekonominë e lirë të tregut. Dhe, më shumë se ky ligj do të jetë ajo se çka do të bëhet më pastaj me punën dhe zhvillimin e kësaj ndërmarrjeje.

Gjatë punës së Komisionit për hartimin e këtij projektligji ka pasur një qasje të ndryshme dhe është krejt normale. Qasja ka qenë prej modelit të kaluar të rifunksionalizimit të “Trepçës”, qasja ka qenë me atë që quhet ndërmarrje e plotë publike, që mendoj se s’i ka attribute të jetë sikur ndërmarrje të tjera dhe është gjetur një zgjidhje adekuate, po them, për momentin, me një kompromis 80 me 20%, duke dashur që të respektojmë punëtorët, të cilët kanë punuar apo punojnë momentalisht në “Trepçë”.

Natyrisht se ne duhet të jemi të kujdesshëm me disa çështje elementare. E para, që në asnjë rast, këtë besoj jo për ne që jemi në këtë sallë, por është mesazh edhe për të tjerët, “Trepça” nuk do të jetë dy njësi. Do të jetë vetëm një ndërmarrje e përbashkët - shoqëri aksionare e përbashkët, me një menaxhim, me një bord. Dhe kjo duhet të jetë e qartë për ne që jemi në këtë sallë, por edhe ata të cilët nuk janë në këtë sallë.

Çështja e dytë, për të cilën duhet të jemi po ashtu të kujdesshëm, është thënë edhe me Kushtetutën e Kosovës, resurset natyrore minerare janë të garantuara për interesin publik dhe nuk ka mundësi të shfrytëzohen ndryshe, përjashtimisht të asaj që është paraparë me lejen për licencë nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale dhe që trajtohen si pjesë të interesit publik. Pra, edhe këtu nuk është pjesë e negocimit që mund të bëhet me ligjin.

Më lejoni të them se ky projektligj, që është një fakt se ne po i ikim nga pak, ka paraparë edhe obligimet ndaj kreditorëve të mundshëm, të supozuar, që mund të jenë apo mund të mos jenë, por megjithatë është një zgjidhje adekuate, që i jep një obligim më të madh Agjencisë Kosovare

të Privatizimit, mirëpo në rastet e tjera, unë jam i bindur se këto do të zgjidhen në procedura të ndryshme, qoftë arbitrazhe apo edhe gjyqësore.

Më lejoni të them, për atë që u përmend më herët, çështjen e aseteve. Ju e dini se momentalisht këto asete i ka pasur në menaxhim AKP-ja. Por, ajo që dua të them, me aprovimin e këtij ligji po ashtu do të kalojë në menaxhimin e duhur të atyre proporcioneve, që po i përmendi 80 me 20 dhe me bordin e ri.

U përmendën në veçanti, edhe dy çështje, kompetencat e Kuvendit në këtë drejtim dhe çështja e dytë që ka të bëjë edhe me integrimin në atë pjesë, dhe nuk mund t'i ikim reagimit që mund ta ketë realiteti në atë pjesë të Kosovës.

E para, sa i përket Kuvendit. Ka tri-katër gjëra që Kuvendi mund të ruajë proporcionin. Dhe fillimisht, më lejoni të them, si jurist se kur Kuvendi është në disproporcion me qeverinë, bie qeveria, kjo dihet kudo në botë. Pra, Qeveria nuk ka diçka ndryshe prej Kuvendit. Por, megjithatë unë mendoj që edhe për hir të disiplinimit në thonjëza, po e them të Qeverisë, mund të bëhen disa gjëra.

Atë që e përmendi profesor Hamiti, besoj për mua nuk është problem. Propozimi të vijë nga Bordi, të miratohet në Qeveri dhe të marrë pëlqimin në Kuvend për investime të mundshme, ndryshime të statuseve dhe unë mendoj që, nëse veç Kuvendi pajtohet, nuk është diçka e madhe.

Çështja e dytë. Mendoj se bordi, mund të pajtohemi, t'i raportojë Kuvendit në baza vjetore për punën që e bën në menaxhimin e kësaj ndërmarrjeje.

Dhe, e treta, nëse po ashtu pajtohemi, mund të jetë edhe çështja e statutit, ashtu sikur që aprovohet statuti i Universitetit në Kuvendin e Kosovës, mund të aprovohet edhe statuti i kësaj ndërmarrjeje në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe mendoj që s'ka kurrgjë të keqe, që nënkupton se edhe ndryshimi eventual i këtij statuti duhet të kalojë nëpërmjet Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Mendoj që kjo është një siguri më e mirë juridike, por njëkohësisht një transparencë edhe përballë qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Më lejoni të përmendi edhe një fakt se moszhvillimi apo mosintegrimi i pjesës veriore të Kosovës ka ndikuar drejtpërdrejt në moszhvillimin e "Trepçës". Unë jam i bindur plotësisht, jo vetëm për minoritetin serb që janë në Kosovë, por po e them edhe për të tjerët, zhvillimi ekonomik i "Trepçës" do të ndikojë pozitivisht në integrimin e asaj pjese.

Pra, ne sot po bëjmë një çelës jo vetëm për zhvillimin ekonomik të të gjithë qytetarëve, pa marrë parasysh etninë e tyre, por po e bëjmë një çelës edhe për mundësinë e integritit, ngase popujt integrohen më së lehti nëpërmjet integritimeve ekonomike.

Pra, në këtë drejtim, nuk duhet t'i trembet askush një ligji për "Trepçën", askush nuk duhet t'i trembet një organizimi të mirëfilltë. Unë ju garantoj se shumica e qytetarëve të Kosovës janë të interesuar ta shohin "Trepçën" si zhvillimi gjigant ekonomik. Askush prej neve nuk është i interesuar që të shohë keq zhvillimin ekonomik të "Trepçës". E çka i bie kjo? Proporcionalisht do të jetë zhvillimi pozitiv edhe për atë pjesë të Kosovës që "Trepça" ekziston fizikisht, e kam mendjen te Zveçani, Leposaviqi apo edhe diku tjetër.

Dhe, krejt në fund, më lejoni të them se ne duhet të jemi të vëmendshëm dhe ta mbështesim edhe në kuptimin e afateve ligjore për Dhomën e Veçantë të Gjykatës Supreme. E di që kemi mund ta sjellim më herët, nuk ka asnjë dilemë, por më lejoni ta them pak sa në mënyrë të butë. Të kishte ardhur ligji më herët, të kishte afat më shumë për ta diskutuar në Kuvend, kishte me pas prej kohe ndryshime jo pozitive mu për këtë ligj. Kjo nuk do të thotë se Kuvendi s'ka të drejtë tash të japë propozime të mira, por propozimet që mund të vijnë nga jashtë Kuvendit kanë mundur të prekin negativisht përmbajtjen e këtij ligji.

Unë mendoj se kjo përmbajtje është për momentin më e mira, i hap mundësi studimit të fizibilitetit dhe strategjisë për zhvillimin e "Trepçës".

Ne jemi këtu, kushdo që është në Qeveri apo Kuvend, dhe çdo studim i fizibilitetit, çdo strategji e zhvillimit ekonomik do të japë mundësi edhe për ndryshimet eventuale që mund të jenë qoftë në menaxhim apo zhvillime të tjera ekonomike për "Trepçën".

Ju ftoj që me propozimet tuaja ta miratoni këtë projektligj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ndërkohë, para se t'ia jap Visarit fjalën, kemi disa propozime konkrete. Pra, në qoftë se nuk i dorëzoni të shkruara, faktikisht edhe nuk do të jenë fare pjesë e leximit të dytë, flas të Komisionit, pra do të ishte mirë të shkruara t'i dorëzohen Komisionit.

(Ndërhyrje)

Faleminderit! Kjo është pedanteria! Visar Ymeri e ka fjalën. Mendoj se s'është replikë, Visar, prandaj edhe mos e zgjat shumë.

VISAR YMERI: Po mirë, i paskam të flasë 10 minuta!

Së pari, jemi te 12:12 që e problematizova edhe më herët, te kapitulli 5 i Ligjit, që thotë kështu:

Pika e parë: “Trepça” sh.a., në kuadër të procesit të transformimit dhe ristrukturimit, me qëllim të krijimit të kushteve për zhvillimin e saj, do të krijojë mundësi për të qenë atraktive për investues privatë, vendës dhe të jashtëm në format si vijon, pastaj radhitet partneriteti publiko-privat, investimet direkte private, investimet e përbashkëta, emetimi dhe shitja e aksioneve. Këto janë me ligj. Janë të shkruara e zeza në të bardhë. Pra, nëse dikush thotë që njëra prej këtyre formave nuk është privatizim i pjesshëm së paku, atëherë unë nuk di çka të them për privatizimin. Për mendimin tim, më së miri e tregon rrugën përpara të cilën po do ta ndjekë Qeveria me “Trepçën”, e rrjedhimisht e ka sjellë këtë ligj këtu.

Tash këto fjalët sesi “o do ta bëjmë shtetërore, shtetëzim të ‘Trepçës’”, siç e dëgjova, “o do ta privatizojmë”, mendoj që e shmangin atë që e kemi thënë për një kohë të gjatë edhe në Kuvend, e që është ndërmarrja publike.

Pra, shndërrimi i “Trepçës” në ndërmarrje publike, prapë po e them, do ta bënte “Trepçën” shoqëri aksionare, sepse ndërmarrjet publike janë të organizuara si shoqëri aksionare, mirëpo qeveriset nga Ligji për ndërmarrjet publike. Trepça sh.a. qeveriset nga Ligji për shoqëri tregtare, me përjashtim të një a dy aspekteve që janë të realizuara në ligj.

Tash, profesor Mustafa po thotë që nuk përjashtohet Kuvendi, profesor Hamiti po thotë që përjashtohet Kuvendi, rrjedhimisht duhet plotësuar njërën prej pikave aty të neneve për ta bërë Kuvendin pjesë në vendimarrje. Atë që e thashë edhe unë.

Pra, që “Trepça”, vendimarrja për “Trepçën”, për transformimin e saj në forma të ndryshme, investimet, shuarjen, shtruarjen e kështu me radhë, siç thuhet në ligjin aktual, do të merren si vendime nga Bordi Mbikëqyrës, natyrisht në bashkëpunim me Qeverinë, duke qenë se Qeveria është pronare e 80% të aksioneve, jo me Kuvendin. Profesor Hamiti propozoi të shtohet edhe Kuvendi, që Kuvendi ta miratojë çfarëdo transformimi, e kështu me radhë. Kjo e bën Kuvendin pjesë në vendimarrje në disa aspekte për “Trepçën”, ama ligji aktual qysh është nuk ia krijon mundësinë Kuvendit fare që të marrë vendime për “Trepçën”.

Për sa i përket shitjes së “Trepçës”, unë e thashë edhe atëherë në fjalën time fillestare, që ideja është që të shitet ose në nivel të njësive biznesore, ose privatizim-shitje e pjesshme e “Trepçës”, sepse këtu në këtë ligj kur e lexon askund nuk shkruan, të paktën në formë të përgjithësuar, se cili është obligimi që po e merr shteti karshi “Trepçës” me ndryshimin e këtij ligji. Përveç që po merr në pronë 80% të aksioneve, askund pastaj nuk tregohen cilat janë përgjegjësitë e Qeverisë së Republikës së Kosovës karshi “Trepçës”, funksionimit të saj, rivitalizimit të saj dhe rritjes së saj.

Pra, e vetmja gjë që parashihet me ligj është përfshirja e kapitalit privat në “Trepçë” dhe aty nuk bëhet kurrfarë dallimi në cilën njësi të “Trepçës”. Pra, të gjitha këto barazohen. Për shembull,

nuk mund të thuhet që duhet të trajtohen njëjtë minierat me flotacion nga metalurgjitë, po as metalurgjitë pastaj nga industria kimike, e as industria kimike e metalurgjisë dhe minierat nga komponentët tjerë të Trepçës që janë kryesisht, po flas këtu për fabrikat që kanë qenë të specializuara në përpunimin e produkteve finale për t'i nxjerrë në treg.

Këtu, ky ligj i barazon të gjitha, thua ti të gjitha këto janë në gjendje të njëjtë dhe thua ti të gjitha këto e kanë rëndësinë e njëjtë, gjë që nuk është e vërtetë.

Për sa i përket pastaj asaj që e dëgjuam përciptazi, që me këtë ligj edhe integrohet pjesa veriore e “Trepçës”, e kështu me radhë, mendoj që është indikativë ajo që e tha Isa Mustafa në fjalën e tij fillestare, kur tha që njësitë biznesore do të mbeten të pavarura, autonome me gjasë, e përmendi fjalën, në veprimtarinë e tyre, dhe kjo autonomi më së shumti mendohet për njësitë biznesore që bien në pjesën veriore, të cilat, siç na propozoi Hajredin Kuçi duhet t'i trajtojmë sikur një realitet i veçantë, sepse atje është një realitet i veçantë.

Pra, edhe me këtë ligj Qeveria e Kosovës po e pranon veçantinë institucionale, reale e faktike në veri. Pra, nuk është këtu ideja që të bashkohet “Trepça” me këtë ligj, por të formalizohet ky ekzistim i ndarjes së saj, po tash jo në dy ndërmarrje, por nëpërmjet një ombrelle të shoqërisë aksionare përmbi dhe pastaj ndarje në nivel të njërive biznesore. Kjo është kamuflimi që po i bëhet ndarjes aktuale reale të “Trepçës” për ta formalizuar atë në ndarje ligjore. Kjo është pra. Ky është realiteti, të cilin po...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: A e kreve Visar? Tash do të vazhdojmë, Besim Beqaj e ka fjalën. Para se ta marrë fjalën Besimi, vetëm pak qetë!

Kërkoj falje! Rrethanat nëpër të cilat kemi kalua si Kuvend të gjithë i dimë, por sa herë po e shkeli Rregulloren shumë po kanë qejf këta më të zëshmit që më kritikojnë dhe më mësojnë për Rregullore. Urdhëro, zoti Ismet Beqiri, Besim Beqaj bëhu gati për diskutim.

ISMET BEQIRI: Zoti kryetar!

Në një mënyrë u përgjigje në atë çka desha ta them. Këtu flasim për respektim të Rregullores, të ligjeve e tjera, kur ia jep nga dy herë fjalën nuk di të ndalet hiç. Të kisha lutur, respektoje Rregulloren, sepse unë kam reagime edhe të deputetëve, të mos i maltretojnë të njëjtit njerëz, sepse s'kanë të drejtë sipas Rregullores. Le të flasim të gjithë deputetë, është e drejtë e tyre, po jo dikujt t'i jepet fjala dy herë nga 10 minuta e të na i përsërisë të njëjtat gjëra, t'i komentojë secilit. Unë kam dashur në fillim të reagoj, edhe në emër të grupit, kam shumëçka të them edhe në paraqitjet e tyre karshi neve, cilësimi, e të gjitha ndaj deputetëve, por nuk po merrem me këtë, e nëse ua jep fjalën mund t'ua japësh në replikë, por mos ua jep zoti kryetar fjalën nga 10 minuta

të njëjtëve njerëz, sepse po shihet që ata që janë për rregull e për rend, veç vetë nuk e respektojnë, e ndaj tjerëve kërkojnë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Vërejtje me vend. Besim Beqaj e ka fjalën, le të përgatitet Sadri Ferati.

BESIM BEQA: Faleminderit, i nderuar kryetar!

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Nëse dëshirojmë që ta kemi një debat parlamentar është mirë që argumentet për secilën çështje t'i themi ngadalë, pa ndonjë farë euforie.

Ligji të cilin e kemi para vetes për "Trepçën" besoj që e ka një synim të mirë. Është një ligj i cili tenton ta nxjerrë "Trepçën" nga gjendja e krijuar me vite të tëra dhe është një angazhim i gjatë institucional për të gjetur rrugëzgjidhje për të.

Atë çka Qeveria e Republikës së Kosovës që në start e ka menduar kur kemi folur për Ligjin për "Trepçën" si ligj të veçantë, besoj që duhet të shkojmë në atë drejtim, sepse për momentin ligji për të cilin e kemi para vetes është afërsisht ligj për ndërmarrjet publike, por që nuk jap status të veçantë sikur kemi menduar edhe më herët sa i përket ndërmarrjes "Trepça".

Pra, ne e kemi një përcaktim që është substancial, që shkon në harmoni me Kushtetutën e Republikës së Kosovës e në interes të qytetarëve, për ta bërë një kompani e cila i integron edhe pjesën jugore dhe pjesën veriore dhe besoj që ky është synimi themelor dhe e arritura kryesore e ligjit që e kemi para vetes, por sigurisht që në organet qeverisëse dhe në rregullimin ligjor të cilin e kemi para vetes duhen ca amendamente, të cilat do ta plotësonin dhe do t'ia jepnin statusin dhe karakterin e veçantë të ndërmarrjes publike me karakter të veçantë.

U tha këtu që ka probleme me nene të caktuara të ligjeve. Unë dua të them që pika 9, te neni 9, ku flitet për transformimin, në komision unë do të parashtoj amendament për ta ndryshuar, sepse nuk mund bordi të marrë vendim për transformim. Vendimin për transformim duhet ta marrë Kuvendi në harmoni me Ligjin për ndërmarrjet publike.

Kjo është një çështje të cilën unë do ta parashtoj si amendament në komision dhe për ta përforcuar ende më tutje besoj që te neni 12 do ta japim edhe një amendament tjetër shtesë, ku thuhet që "procesi i transformimit dhe strukturimit të ndërmarrjes "Trepça" do të bëhet në harmoni me Ligjin 03/L-087 për ndërmarrjet publike", e cila paraprakisht kërkon që çdo vendim për shitjen e aksioneve apo të aseteve të një ndërmarrjeje publike duhet të merret nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Njëkohësisht një çështje tjetër e cila nuk është theksuar në ligj dhe që duhet të theksohet dhe prapë do ta paraqesim si amendament në komision është trajtimi i pasurive që i ka “Trepça” jashtë Kosovës, duhet të adresohen edhe si çështje të tilla.

I nderuar kryetar,

Të nderuar deputetë,

Ne e kemi para vetes një ligj, e kemi një synim të mirë të Qeverisë, e cila nuk besoj që ka mund në mënyrë më të mirë të mundshme t’i artikulojë të gjitha këto kërkesa, por ndërmjet dy leximeve me amendamente do ta plotësojmë dhe do ta bëjmë një ligj i cili do t’ia japë karakterin e veçantë “Trepçës” si ndërmarrje publike, jo si të gjitha ndërmarrjet publike, por si ndërmarrje me status të veçantë në kuadër të Ligjit për ndërmarrjet publike. Faleminderit!

KRYETARI: E përshëndesim kryetarin e Komunës së Mitrovicën, zotin Agim Bahtirin, që e kemi këtu të pranishëm.

Ndërkohë urdhëro fjalën Profesor. Muhamet Mustafa e ka fjalën, ndërkohë Sadri Ferati e merr fjalën menjëherë.

MUHAMET MUSTAFA: Ju lutem shumë shkurt për arsye se këtu po flasim para opinionit.

Pika 5, në faqen 14, prej 18 faqeve, thotë “për investimet në metalurgji dhe në përpunim të metaleve dhe në industrinë kimike, Qeveria e Republikës së Kosovës”. Ju lutem, se tha dikush Qeveria nuk merr obligim. Në ligj thotë Qeveria e Republikës së Kosovës si aksionari kryesor do të angazhohet për të investuar në bashkëpunim me investitorët privatë, po mund edhe vetëm besa. Sigurisht! Prandaj, ligji krijon obligime edhe për Qeverinë e Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Tash i kemi dy deputetë në radhë, Sadri Feratit po i japim përparësi, le të bëhet gati Raif Qela.

SADRI FERATI: Faleminderit!

Përshëndetje kryetar,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë,

Pas 16 vjetësh diskutime, debate, elaborate e analiza, më në fund çështja e “Trepçës” ka ardhur në rend të dite dhe ne shpresojmë që sot do të merret vendimi i riorganizimit të saj dhe është krejt e natyrshme që kjo e ka krijuar një disponim të mirë të gjithë neve këtu, por edhe të gjithë opinionit që na përcjell dhe me padurim e pret përfundimin e këtij takimi dhe votimin e Ligjit të veçantë për “Trepçën”.

Duke mos e vënë pikën, duke lënë vend që të përmirësohet kjo akoma, siç edhe dëgjuam ide të mira dhe mundësia e amendamentimit ndërmjet dy leximeve, po fundja që Ligji për “Trepçën” të rishikohet edhe pas një apo dy vjetëve të tjera, në momentin që ligji ka ardhur në Kuvend unë shoh disa rezultate pozitive, gjë që më gëzon edhe mua, por i gëzon edhe gjithë njerëzit e mirë të Kosovës.

Me ligjin, më në fund, do të krijohet korniza legjislative që e garanton valorizimin e pronës së “Trepçës” dhe do të bien pra në ujë të gjitha pretendimet që xehet e pasura të “Trepçës” të shiten me çmimin e zhavorrit, meqë ka pasur aso pretendimesh dhe në njëfarë forme propozime të asaj natyre.

Në anën tjetër, një përvojë 50-vjeçare ka filluar të rrezikohet, prandaj aktivizimi sa më i shpejtë i ligjit garanton aktivizimin e potencialit ekzistues në kuadër të vetë “Trepçës”, por edhe të shumë kadrove të mira, të cilët kanë dije dhe përvojë që do të mund të aktivizohen dhe t’i ndihmojnë zhvillimit dhe implementimit të mëtejshëm të ligjit.

Çështje tjetër shumë e rëndësishme - përshpejtimi i të gjitha punëve, është që vetëm “Trepça” i ka parakushtet të shndërrohet në një qendër rajonale dhe regjionale e përpunimit të xeheve të metaleve të plumb-zinkut.

E di që me aktivizimin e “Trepçës” do të ketë interes edhe vetë buxheti i shtetit, por mbi të gjitha ne mund ta kemi konsideratë gjithë sakrificën e të gjitha natyrave që e kanë bërë minatorët dhe qytetarët e këtyre lokaliteteve. Por, për ironi të fatit, aty ku këto rezerva, për të cilat ne po flasim, janë më të mëdha fukarallëku është më i madh.

Ata që e njohin Mitrovicën dhe regjionin e Mitrovicës, e kanë parasysh, dhe ata që e njohin Novobërdën, Kishnicën, Artanën, po ashtu e kanë parasysh dhe do të mund të kuptojnë se çka thashë.

Këto ditë është shpallur një konkurs në parapërgatitjen e marrjes së punëtorëve dhe për 100 minatorë kanë konkurruar afro 1 000 veta, dhe jo vetëm kjo - ne minatorit ia njohim sakrificën dhe mund edhe këndojmë, gjë që e meriton, por halli i madh i vetë minatorit është se pas përfundimit të shekullit të tij të punës çfarë do të ndodhë me fëmijën e tij, a do të mund ai të punësohet në “Trepçë”, por jo vetëm minator, por edhe kuadro të mundshme, meqë ai me djersën e ballit i ka shkolluar, i ka arsimuar dhe i ka specializuar për të mundur pastaj që të investohet ajo dije me këto kapacitete.

Dhe, pikërisht gjithë ky kompleksitet i kësaj situatë, edhe një diçka do të ketë parasysh. Ne, edhe përkundër definimit të kësaj situatë, e dimë që kapitali i freskët dhe sidomos pas daljes së pasurive nga flotacionet do të ketë nevojë për ndërtimin e kapaciteteve në shkretoren e plumb-

zinkut, por edhe në kapacitetet përpunuese dhe e gjithë kjo do të jetë e mundshme në investimet e kapitalit të freskët, që këtu është fuqia e ligjit që i lë vend kombinimit investimit privato-publik.

Pra, marrë në tërësi, me të gjitha idetë e mira, sot për Ligjin për “Trepçën” i thërras të gjitha palët që të investohemi e ta votojmë, ta krijojmë një disponim të mirë, në mënyrë që pas një afati shumë të shkurtër ne t’ia bëjmë një analizë dhe të shohim se cila do të jetë rëndësia e madhe e implementimit të ligjit për shtetin e Kosovës, për Buxhetin e Kosovës, për minatorët, për punëtorët, jo vetëm të minierave, por për të gjitha kapacitetet përpunuese, për qytetarët e këtyre lokaliteteve nga vijnë pasuritë, por edhe për qytetarët e Kosovës, në tërësi.

I bindur se ligji do të kalojë në formën më të mirë, atëherë edhe unë do të shpreh kënaqësinë time që jam pjesë e këtij Parlamenti, që sonte do ta votojë Ligjin e veçantë për “Trepçën” Faleminderit!

KRETARI: Faleminderit! Raif Qela e ka fjalën, ndërkohë dy të “Vetëvendosjes”. Rrustem, ta kam bërë padrejtë, menjëherë pas dy të “Vetëvendosjes”, se ankohet “Vetëvendosja”, duan për ta respektuar Rregulloren. Glauku e ka fjalën, edhe Ismajli, pastaj Rrustemi.

RAIF QELA: Të nderuar deputetë,
Kryeministër,
Kabinet qeveritar,

Para nesh e kemi Projektligjin e shumëpritur të “Trepçës”, i cili kaloi nëpër një odiseadë të tërë.

“Trepça”, siç e dimë, ka qenë një kohë ndër shtyllat kryesore të zhvillimit ekonomik të Kosovës, e sot ajo është në agoni. Është në agoni që rreth 26 vjet për shkak të rrethanave politike, por edhe për shkak të ashtuquajturit “status pronësor të papërcaktuar”, respektivisht thënë më mirë të mjegulluar për shkak të disa interesave të dyshimta.

Sot me këtë projektligj, dhe besoj që do të bëhet edhe ligj i mirë, do t’i çelët rruga zhvillimit të “Trepçës” dhe me këtë edhe do t’i jepet një shtytje zhvillimit ekonomik të Kosovës, nga një potencial ekonomik i fjetur, “Trepça” do të shndërrohet në njërin prej shtyllave të zhvillimit ekonomik të Kosovës.

Problemet që i kemi pasur me vonesën në këtë projektligj i kemi përmendur shpesh këtu. I kemi përmendur edhe në Komisionin për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, edhe në këtë Kuvend, dhe shpeshherë e kemi kritikuar Qeverinë për këtë vonesë.

Unë kam qenë njëri prej tyre që e kam kritikuar shumë Qeverinë lidhur me vonesën për këtë projektligj. Sot, për shkak të rrethanave të krijuara, unë mendoj se nuk kemi arsye ta kritikojmë për këtë vonesë.

Rrethanat që të gjithë po i shohim, po i dimë. Prandaj, ju lus për mirëkuptim lidhur me këtë çështje.

Në projektligjin e sjellë këtu te ne vërehen disa shmangie prej propozimit që ka bërë komisioni i formuar nga Qeveria dhe një prej atyre është edhe lidhur me faktin se janë hequr dy metalurgjitë dhe industria kimike, që për bindje time nuk është farë gabimi, për arsye se tani për tani, si metalurgjitë, si industria kimike, janë krejtësisht jofunksionale dhe nuk luajnë ndonjë rol në funksionalizimin e “Trepçës”.

Problemi kryesor me këtë projektligj për bindjen time është ky: Kanë mbetur të patrajtuara mbetjet teknologjike. Dihet mirëfilli se njëra nga pasuritë e “Trepçës” janë edhe mbetjet teknologjike që dikush do t’i trajtojë si mbeturina.

Mbetje teknologjike, në veçanti mbetjet minerale janë diku rreth 68 milionë tonë dhe vlera e tyre është disa qindra miliona euro, mbase edhe i afrohet një miliard euro pasurisë, të cilën nuk e trajtojmë me këtë ligj.

Mendoj se ka rëndësi të jashtëzakonshme që kjo të bëhet pjesë e ligjit për arsyen e thjeshtë, sepse ka mundësi që këto të valorizohen, të përpunohen dhe jo vetëm të shiten si të tilla çfarë janë, por ka edhe interesime të investitorëve të huaj që të vijnë këtu dhe ta përpunojnë këtë, të krijohen vende të reja pune dhe të krijohet mundësia që prej këtyre të përfitohet e të nxirren të gjitha ata përbërës, metale të radha, të cilat nuk kanë mundur të nxirren me teknologjitë e deritanishme.

Teknologjia ka ecur shumë përpara në këtë fushë dhe ka mundësi që pikërisht këto mbetjet teknologjike të patrajtuara të bëhen njëra prej shtytjeve të mëkëmbjes së “Trepçës”, për arsyen shumë të thjeshtë se disa herë kur ka qenë “Trepça” në krizë, me shitjen e këtyre mbetjeve minerale ka dalë nga kriza, e jo më edhe t’i jepet mundësi që këto të përpunohen me investimet e jashtme.

Qeveria do të duhej ta kishte parasysh këtë fakt dhe do të duhej ta mbështeste edhe amendamentin përkatës, në mënyrë që edhe vetë ta ketë një mundësi më të madhe që të kontaktojë drejtpërdrejt me investitorët potencialë në këtë fushë.

Amendamenti konkret mendoj që do të duhej të ishte kështu: Në nenin 5, resurset minerare, bartja e pasurisë, të drejtave dhe burimeve njerëzore, duhet t’i shtohet edhe paragrafi 5.5, me

këtë përmbajtje: “‘Trepça’ sh.a. e trashëgon të drejtën e valorizimit të mbetjeve teknologjike nga e kaluara dhe trajtimin e tyre në përputhje me standardet mjedisore”.

Lidhur me ndarjen e aksioneve 20% për punonjësit, mendoj se duhet të shqyrtohet se cilat kategori saktësisht do t’i gëzojnë ato, a do t’i gëzojnë vetëm këta qysh është e trajtuar me këtë projektligj, që kanë më shumë se tre vjet përvojë pune në “Trepçë”, respektivisht që kanë qenë punonjës të “Trepçës” në tre vjetët e fundit, apo edhe të tjerë më përpara.

Ka probleme nga pak edhe në kapitullin e dytë lidhur me organizimin, sepse neni 6.2 bie ndesh me pjesën që flet rreth qeverisjes. Mendoj se pjesa rreth qeverisjes ka mundësi të reduktohet dhe të mos hyhet fare në detaje, sepse do të jenë përfaqësuesit e aksionarëve ata që do ta përcaktojnë statusin dhe do ta përcaktojnë edhe mënyrën e organizimit, e nuk është e domosdoshme që ky ligj të merret me ta fare.

Nuk po e zgjas më shumë, por si përmbyllje e përkrah projektligjin në parim, ashtu siç e përkrah edhe Lëvizja për Bashkim, pjesë e së cilës jam unë.

E kemi trajtuar me kujdes, mendoj se duhet t’i jepet përkrahja në parim dhe të angazhohemi në mënyrë që ta nxjerrim një ligj sa më të mirë nëpërmjet amendamenteve. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Glauk Konjufca e ka fjalën. Ndërkohë Ismajli nuk është këtu, le të bëhet gati Rustem Berisha.

GLAUK KONJUFCA: Qytetarë të Republikës së Kosovës,
Deputetë të Kuvendit,

Qe dy herë Qeveria e Kosovës po ndërmer veprime nën tryshninë e kohës, vetëm pak ditë para përfundimit të afatit për likuidimin e “Trepçës”.

Prej herës së fundit ka kaluar më shumë se një vit e gjysmë dhe Qeveria e Kosovës ende nuk ka përpiluar kurrfarë plani konkret për “Trepçën”. Nuk ka as plan të statusit publik për “Trepçën”, nuk ka as plan të rivitalizimit, siç do të dukej ai hollësisht, e as plan të rikthimit të “Trepçës”, ku ka qenë ajo dikur, me prodhimtarinë që e ka pasur në kulmin e funksionimit të vet. Qeveria jonë e ka pasur vetëm një plan për “Trepçën” deri tash, e ky plan ka qenë shmangia e likuidimit, bile këta janë mburrur me shmangien e likuidimit. Shmangien e vdekjes së “Trepçës” e kanë shpallur si njëfarë suksesi suprem, thua që kjo është qëllimi përfundimtar për “Trepçën” të mos lihet të vdesë.

Mirëpo, për “Trepçën” nuk është e mjaftueshme të mos lihet të vdesë, “Trepçën” duhet zhvilluar dhe ta kthejmë në ditët e lavdisë së saj të dikurshme. Prej shmangies së likuidimit deri te një

“Trepçë” prodhuese dhe plotësisht të rivitalizuar për Qeverinë tonë në mes ekziston një hendek gjigant dhe të cilin ajo nuk ka vullnet ta kapërcejë.

Qasja e Qeverisë ndaj “Trepçës” ka qenë kjo: që në “Trepçë” të investohet aq sa është e nevojshme që ajo të mbahet në aparaturën e reanimacionit. Pra, frymë artificiale dhe infuzion deri në momentin kur pacienti është i gatshëm të shitet. Kjo është e mjerueshme, ka qenë e mjerueshme dhe nuk është përgjegjësi vetëm e kësaj Qeverie të Isa Mustafës, por ka qenë qasje konstante e të gjitha qeverive prej vitit 2001.

Dhe, jo vetëm që “Trepça” është braktisur, është lënë anash, nuk ka qenë në fokus të zhvillimit ekonomik të Kosovës, por aty bile edhe është vjedhur dhe hajnat duhet të kapen prej drejtësisë. E kam një problem shumë të madh me Qeverinë e Kosovës se si e koncepton “Trepçën” dhe të gjithë zyrtarët qeveritarë të deritashëm se si e kanë konceptuar atë”.

“Trepça” konsiderohet si njëfarë makine e vjetër, si njëfarë veture e vjetër e viteve ‘70. Pra, kur është prodhuar në vitin ‘70 ka qenë e re, e fortë edhe e shpejtë, por tash pas 40 vjetëve është vjetruar dhe është amortizuar. Pra, nuk ka vlerë, është pavlerë, është e vjetër, është prishur. Ky është një gabim trashanik se metalet dhe mineralet janë një pasuri progresive. Sa më shumë që ecën koha, çmimi i tyre rritet, kërkesa për to shtohet, prodhimi i tyre ka leverdi të vazhdueshme, aq më tepër nëse aty ka ar, argjend apo metale të çmuara siç është indiumi.

Në “Trepçë” ekzistojnë 60 lloje të mineraleve dhe vlera e tyre është marramendëse në tregun e sotëm. Si është e mundur ta kemi gjithë këtë pasuri natyrore dhe të jemi me këtë varfëri shoqërore dhe me këtë prapambeturi ekonomike. Si është e mundur që “Trepça” funksionon vetëm me 10% të potencialit të saj të prodhimtarisë të viteve ‘70-ta apo ‘80-ta.

Këtë nuk di ta shpjegoj ndryshe, përpos si një mallkim politik që në vazhdimësi i ka ndodhur Kosovës. Në Kosovë ka shumë agjentë ekonomikë, të cilët e shesin idenë se “Trepça” është e mbivlerësuar, se pasuria e saj është mitike, se rezervat e saj të pretenduara janë iluzore, se makineritë janë të vjetra dhe pa vlerë, dhe se investimi i milionave në “Trepçë” nuk ia vlen fare. Jam i sigurt dhe për shumicën prej këtyre agjentëve ekonomikë edhe mund të vë bast se shumica e tyre do të përfundonin si administratorë të atyre që duan ta blejnë “Trepçën”, që do të jenë blerës të ardhshëm të “Trepçës”.

Qeveria ndaj “Trepçës” e ka pasur gjithmonë një arsyetim që për të nuk kemi para, kur thuhet për “Trepçën” “nuk kemi para”, ti e ke konceptin që në të nuk ia vlen të investosh, por unë mendoj, zonja dhe zotërinj, që “Trepça” ka vuajtur për këtë arsye vetëm për një fakt shumë të thjeshtë. Ajo nuk ka qenë gurthyes edhe nuk ka qenë asfalt, se po të kishte qenë “Trepça” gurthyes edhe po të kishte qenë asfalt, unë mendoj që ishin gjendur edhe qindra miliona euro prej Qeverisë që

të investojë edhe për ta kthyer në gjigant ekonomik. Por, mallkimi i “Trepçës” është që nuk ka qenë gurthyes dhe nuk ka qenë asfalt.

Pra, Qeveria e Kosovës e ka pasur gjithmonë një qasje të dykuptimshme apo më mirë të thuhet, paradoksale: në njërën anë thirret vazhdimisht në lavdinë e “Trepçës”, e quajnë “gjiganti ekonomik i Kosovës”, por në anën tjetër investimet nuk kanë qenë në përputhje me deklaratat e vazhdueshme të tyre. Investime nuk ka pasur, kuadrot profesionale nuk janë përfillur kurrë, njerëzit që e kanë udhëhequr “Trepçën” kur ka qenë në kulmin e saj, shumica prej tyre janë ende gjallë. Punëtorët që kanë punuar në “Trepçë”, kur ka qenë në kulmin e saj edhe prej tyre një pjesë e konsiderueshme janë gjallë. Ata e dinë qysh merr frymë “Trepça”, ata e dinë qysh ngrihet “Trepça”, por ata nuk i pyet askush. Ekziston madje edhe një fizibilitet shumë i hollësishëm, të cilin unë e kam parë me sytë e mi. Është i po këtyre ekspertëve vendorë, i këtyre punëtorëve që gjithmonë kanë kontribuar në “Trepçë”, por Qeveria i jep para të tjera, të taksapaguesve, për fizibilitete të huaja që na tregojmë çka kemi, çka s’jemi e kush jemi.

Zonja dhe zotërinj, për qymyr, për energji elektrike, për miniera e për minerale Kosova gjithë diqysh i ka pas ditur punët e veta goxha mirë. Ku qëndrojmë e qysh qëndrojmë. Por, tash këto analiza po na i bëjnë ekspertët e korporatave që po duan ta blejnë “Trepçën” e që thonë nuk ia vlen që të investojmë se ata duan të investojnë vetë. Nuk janë të interesuar që krejt fitimin taketë publiku edhe populli i Kosovës, që paratë të shkojnë në buxhet të Kosovës. Por, që paratë të shkojnë në xhepat e disa investuesve privatë, kjo është e vërteta.

Dhe, në fund, përjashtimi i Kuvendit është shumë shqetësues. Kjo e dobëson vendimmarrjen demokratike në Kosovë. Nëse Kushtetuta i definon mineralet dhe pasuritë e Kosovës që janë pronë e publikut dhe që janë pjesë e sovranitetit shtetëror, atëherë institucioni më i lartë që është në mbrojtje të drejtpërdrejtë të interesave të publikut dhe që është përfaqësues i tyre përmes të zgjedhurve që është Kuvendi i Kosovës, në këtë ligj po përjashtohet prej vendimmarrjes për njërën prej organizatave më të rëndësishme ekonomike të Kosovës.

Kjo e dobëson popullin e Kosovës, populli i Kosovës pas këtij ligji do të jetë më i dobët dhe kjo e rrit pakënaqësinë, sepse populli nuk do të jetë në njëfarë mënyre vendimmarrës në mënyrën qysh është i paraqitur në Kuvendin e Kosovës, por do të jetë i paraqitur në mënyrë të ngushtë, vetëm ashtu qysh është e përbërë Qeveria e Republikës së Kosovës. Kjo i bën më të cenueshme dhe më të rrezikuara pasuritë e Republikës së Kosovës, prandaj kjo nuk duhet të ndodhë në asnjë mënyrë.

KRYETARI: Rustem Berisha e ka fjalën, Ismajl Kurteshi, qenke kthyer, bëhu gati!

RRUSTEM BERISHA: Faleminderit, kryetar,
I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,
Të nderuar deputetë,
Qytetarë të Kosovës,

Problematika e “Trepçës” dhe problemet e saj janë shumë të mëdha edhe sigurisht se lista e atyre problemeve është tejet e madhe, duke u nisur prej statusit që e ka pasur, një status mbijetese, të keqmenaxhimit, e të mos flasim edhe të keqpërdorimeve, por me ligjin të cilin e kemi përpara, ne i kemi dy mundësi: që t’i hapim rrugë perspektivës zhvillimore të “Trepçës”, ose të vazhdojmë me këtë status çfarë ka pasur, të mbijetësës, keqpërdorimit, e të keqmenaxhimit që ka qenë deri më sot.

Unë e di që aty ka shumë probleme, por mua më ka bërë përshtypje një thënie e drejtorit Ahmet Tmava, kur ishte fjala për bashkëpunimin e punëtorëve, i cili tha: “Ne me punëtorët e minoritetit serb bashkëpunojmë shumë mirë, por përderisa nuk përzihet politika e Beogradit. Në momentin që përzihet politika e Beogradit, ne kemi probleme të shumta, atëherë nuk mund të kemi një bashkëpunim dhe një koordinim të mirë”.

Ne kontributin tonë e kemi përgatitur me amendamente dhe i kemi 9 amendamente, të cilat do t’i prezantojmë në Komision për Zhvillim Ekonomik dhe në ato amendamente janë në formë të shkruar, pa dashur t’i lexoj secilin, po përfshihet edhe roli i Parlamentit, edhe pjesëmarrja e punëtorëve në aksionet që nga viti i minatorit, që nga viti ’89, pastaj, asetet e jashtme e shumë e shumë të tjera. Pra, ne kontributin tonë do ta japim në komisione, por njëkohësisht i ftoj të gjithë deputetët që të kemi qasje sa më serioze, sepse vetë Ligji për “Trepçën” është shumë serioz dhe ta kryejmë, se mund të debatojmë deri nesër këtë çështje, por më mirë vërejtjet tona, mendimet tona, t’i japim në komision edhe të kalojmë në leximin e dytë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ismajl Kurteshi e ka fjalën, ndërkohë Ramiz Kelmendi, pa grup parlamentar.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit,
Qytetarë të nderuar,
Deputetë,

Ne sot që jemi në këtë sallë edhe pjesëtarët e Qeverisë edhe deputetët pa përjashtim jemi deklaruar se po angazhohemi për të mirën e Kosovës.

Dhe, unë mendoj që sot mund të dëshmojmë se po angazhohemi për të mirën e Kosovës nëse e bëjmë një ligj të mirë për “Trepçën” dhe po ashtu besoj që pajtoheni të gjithë se ligji i mirë nuk mund të bëhet shpejt e shpejt, sepse shpejt e shpejt bëhen gjërat shkel e shko. Prandaj, kërkesa që ky ligj kaq i rëndësishëm t’i kalojë dy lexime brenda një dite, e kjo do të thotë të mos jepet kohë e mjaftueshme për ta bërë një ligj të mirë dhe për ta amendamentuar, edhe pse kohë ka mjaft,

është joserioze dhe në kundërshtim me deklarinimet tona se jemi të angazhuar për të mirën e Kosovës.

Kur njeriu e sheh mungesën totale të seriozitetit dhe përgjegjësinë e këtij koalicioni qeverisës, karshi çështjeve shumë serioze, si kjo e sotmja, nuk ka si të mos i kujtohet thënia aspak e këndshme e Faik Konicës: “Zot, ruaje Shqipërinë prej shqiptarëve”. Ky dhe shumë veprime të përgjegjshme, të ngjashme si kjo që janë të dëmshme për vendin, e karakterizojnë këtë Qeveri të përgjegjshme, të paditur dhe të korruptuar. Prandaj, unë kisha kërkuar nga ky Kuvend që t’u japë kohë dhe mundësi edhe deputetëve, edhe grupeve parlamentare, edhe ekspertëve që të kontribuojnë që ne sot ta kryejmë detyrën tonë karshi vendit, e kjo është që ta bëjmë një ligj të mirë për “Trepçën”, ditët nuk kanë hyrë në thes, ka kohë deri në fund të këtij muaji dhe po vepruam ashtu, askush nuk do të humb dhe do të fitojë vendi edhe “Trepça” në të njëjtën kohë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ramiz Kelmendi e ka fjalën, ndërkohë bëhet gati Abdyl Ymeri.

RAMIZ KELMENDI: I nderuar kryetar i Parlamentit,

Zoti kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Kolegë deputetë,

Ne sot e kemi një Ligj për “Trepçën”, është e vërtetë që është një gjigant i viteve ‘70 deri ‘99. Në kohën e demonstratave të viteve ‘81 motoja e studentëve ishte “Trepça punon, Beogradi ndërton”. Ne edhe në atë kohë nuk ia kemi ditur fuqinë e vërtetë të “Trepçës” për arsye se një pjesë e madhe e mjeteve financiare kanë përfunduar në Republikën e Serbisë, apo në Republikën e ish-Jugosllavisë. Edhe numri i madh i punëtorëve të “Trepçës”, për të cilën ne sot themi që i ka pasur 20 mijë, edhe në atë kohë janë pranuar njerëzit me librezë partiake, me ndryshime të njerëzve të politikës dhe gjithnjë është shtuar numri shumë më tepër se sa ndoshta “Trepça” ka pasur nevojë. Sot, “Trepça” po e ndryshon formën. Po kalon në një shoqëri aksionare me 80% të pronësisë së Qeverisë dhe 20% të pronësisë së punëtorëve, është precedent që punëtorët e “Trepçës” sot po bëhen pronarë të një kapitali pa qenë asnjëherë në raport me qytetarët e tjerë të Republikës së Kosovës.

Sa më larg që i ka duart Parlamenti nga “Trepça” dhe sa më larg që i ka duart politika nga “Trepça”, ajo do të shkojë përpara. Të mos mendojmë se një ligj që ne e kemi sjellë sot, që shumëkush po thotë është kohë e shkurtër e trajtimit të këtij ligji në këtë seancë. Nëse ne i kemi pasur para vetes 17 vjet dhe kemi pasur ekspertë në kuadër të grupeve politike, ky ligj është dashur të jetë i trajtuar dhe i finalizuar dhe mezi të pritej që të vijë dita për të debatuar për këtë ligj ose të ofrohet një formë tjetër e zgjedhjes së çështjes.

Edhe nga dita e nesërme, kur kalon ky ligj, përsëri e kemi një shoqëri aksionare të njëjtë siç ka qenë në të kaluarën. Pa çuar kapital të freskët në “Trepçë”, apo pa e lënë bordin menaxhues të funksionojë në sistemin e ekonomisë së tregut, të gjejë investitorë që kanë kapital të freskët dhe që kapitalin e investuar aty ta trajtojnë dhe ta menaxhojnë ata vetë, e të largojnë dorën edhe të Qeverisë. Pra, nëse ne mendojmë që do të kishim gjetur investitorë që të investojë në “Trepçë” dhe përsëri ne të manipulojmë dhe të çojmë punëtorë, të shtojmë vende pune atje, do të ishte një gabim i madh për investitorin ose një dobi shumë e shkurtër për Republikën e Kosovës.

Prandaj, privatizimi apo shoqëria aksionare është një epokë e re e “Trepçës” që kalon në duart e atyre që e menaxhojnë dhe ju jep mundësi që menaxherët me aftësitë që i kanë apo menaxherët e ardhshëm të zgjedhur nga aksionari kryesor që mund të jetë çdokush tjetër privat, të shkojë rrugës dhe ajo të bëhet një gjigant i punësimit, një gjigant i pagesës së tatimeve, një gjigant që paguan tatim fitim e të mos jetë sikur sot një gjigant që e financon Qeveria e Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! AbdylYmeri, ky ishte diskutim i zjarhtë. AbdylYmeri e ka fjalën, ndërkohë bëhet gati Shpejtim Bulliqi, jemi mësuar veç për demarkacion, Shpejtim, bëhesh gati.

ABDYL YMERI: Faleminderit, kryetar,
I nderuar zëvendëskryeministër,
Ministra,
Të nderuar kolegë deputetë,

Sot është ditë e veçantë që më në fund përmes këtij projektligji po i jepet një rrugëzgjdhje kompleksitetit të gjigantit “Trepça”, i cili është ballafaquar me një varg problemesh të trashëguara nga e kaluara, e që e kanë përcjellë edhe këto vitet e pasluftës, siç janë: mosdefinimi pronësor e juridik, teknologjia e vjetruar, mosinvestimet e duhura në teknologjinë më të avancuar, problemet mjedisore si rezultat i mbetjeve në deponitë industriale, si dhe një varg problemesh të tjera që besoj që përmes këtij projektligji do të zgjidhen këto çështje një nga një.

Ajo që është për t’u theksuar këtu, është angazhimi maksimal i minatorëve dhe i gjithë stafit menaxhues për mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e minierave deri në vënien në funksion të këtij gjiganti, duke arritur që të rritet edhe prodhimi, e në të njëjtën kohë duke krijuar kushte më të mira për punëtorët dhe rritjen e të ardhurave të tyre. Sot para vetes kemi këtë projektligj, i cili definon në mënyrë të qartë të ardhmen e “Trepçës” si shoqëri aksionare, si dhe definohet qartë prona në nenin 5 të këtij projektligji.

Ky ligj është tejet fleksibil dhe ofron zgjidhje përfundimtare që në një formë krijon hapësira dhe hap rrugën për një perspektivë të këtij gjiganti metalurgjik, ku të gjitha institucionet dhe ekspertë të kësaj fushe duhet të jenë dhe të vihen në shërbim të zhvillimit të resurseve dhe kapaciteteve të “Trepçës”, të cilat duhet të përdoren si potencial i fuqishëm për zhvillimin ekonomik të vendit,

duke u shndërruar “Trepça” jo vetëm prodhuese e koncentratit, por edhe e prodhimit final të metaleve me ngjyrë.

Nëse “Trepça” si shoqëri aksionare arrin të krijojë mundësi dhe hapësirë për hapjen e rrugës për investime, rritjen e vlerës së aseteve dhe avancimin e kapitalit tekniko-teknologjik si parakusht për rivitalizim, patjetër se do të ketë edhe më tepër prodhim, zhvillim, krijim të vendeve të reja të punës dhe, natyrisht, rritje të pagave dhe mirëqenies për minatorët. E po ashtu, do t’i përmbushë pritjet e shumta të qytetarëve se me vënien në funksion të resurseve të “Trepçës”, Kosova do të ketë një zhvillim të hovshëm ekonomik.

Në rast se shumëçka na ndanë edhe me mendime dhe ide, sot do të duhej të gjithë të ishim të bashkuar, siç ishin minatorët të bashkuar në vitet më të vështira. Faleminderit!

KRYETARI: Shpejtim, fjala për ju, Shpejtim Bulliqi e ka fjalën, ndërkohë bëhet gati Nenad Rashiq.

SHPEJTIM BULLIQI: Faleminderit, zoti kryetar i Kuvendit!

Ligji që ka ardhur sot në Parlament për “Trepçën” mendoj që është një ligj jashtëzakonisht i rëndësishëm dhe i qëlluar për faktin që kombinati xehetar-metalurgjik “Trepça”ka qenë njëra prej ndërmarrjeve më të rëndësishme të vendit, njëherësh prodhuesja më e madhe me rezerva prej mbi 45 milionë tonelata të plumb zinkut.

Faktikisht ky kombinat ka qenë mburrje për Kosovën, ka qenë i njohur jo vetëm brenda Kosovës, por edhe jashtë Kosovës me rezervat e shquara, por njëkohësisht edhe me prodhimin, i cili diku në vitet e ‘70-ta arrinte shuma ndoshta edhe përmbi 1 milion tonë xehe brenda viti. Sigurisht që shpresojmë se puna që është bërë në këtë ligj nga ana e Qeverisë të jetë bërë mirë dhe të jetë e kompletuar. Por, edhe në rast se ka ndonjë lëshim eventual, mendoj që mund të zgjidhet më vonë duke mënjeluar të gjitha ato lëshime me plotësime, të cilat mund të bëhen edhe më vonë.

Sigurisht që Ligji për “Trepçën” duhet të jetë i rëndësishëm për arsye se do të krijojë mundësi që këtë ndërmarrje ta fusë në binar normal dhe faktikisht të futet në vargun e procesit të prodhimit, duke mënjeluar të gjitha ato lëshime në keqmenaxhimet e ndryshme që janë bërë, deri te keqpërdorimet e ndryshme që janë bërë, sa që ju e dini shumë mirë dhe ne jemi dëshmitarë të faktit që një pjesë relativisht e madhe e atyre mbetjeve, të cilat filluan nëpër periudha të ndryshme kohore të shiten edhe jashtë Kosovës, kanë mbetur në territore të cilat faktikisht i kanë kontaminuar dhe i kanë sjellë relativisht probleme të mëdha mjedisit jetësor.

Shpresojmë që të paktën këto probleme do të mënjanohen me këtë ligj dhe do të fillojë procesi i rivitalizimit të kësaj ndërmarrjeje. Është për të ardhur keq që ligjet e tilla, me rëndësi të veçantë për vendin, gjithmonë po vijnë në periudha të ngutshme kohore në Kuvend dhe, në njëfarë

forme, nuk po na krijojnë mundësi edhe hapësirë që edhe ne të japim kontributin modest në përmirësimin e këtyre projektligjeve.

Në vazhden e kësaj çka thashë më herët, unë e kam edhe një propozim konkret, te neni 9, pika 3, te bordi menaxhuesi “Trepçës”, në të cilën thuhet që në përbërjen e bordit menaxhues duhet të sigurohen ekspertizat e nevojshme nga fusha e ekonomisë, drejtësisë, teknike dhe teknologjike, si dhe kërkesa specifike të përkufizuara me statutin e “Trepçës” shoqëri aksionare, të futet edhe fusha e gjeo-shkencave për faktin që gjeo-shkencat e kanë një vend meritore në suaza të krejt këtyre projekteve, të cilat do të bëhen edhe në të tashmen për “Trepçën”.

Prandaj, mendoj që fushës së ekonomisë, drejtësisë t’i shtohet edhe fusha e gjeo-shkencave, për arsye se edhe në pjesën e parë të këtij ligji faktikisht thuhet që është bërë një ekspertizë në konsulta me ekspertë të gjeo-shkencave, prandaj mendoj që e ka vendin edhe në suaza të këtij neni, përkatësisht të kësaj pike. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, i nderuar! Por, pasi leximi i dytë, është mirë që me shkrim t’i jepet komisionit menjëherë.

Zoti Rashiq, fjala për ju! Në ndërkohë, në qoftë se vjen Donika Kadaj-Bujupi e merr fjalën, ose Shqipe Pantina në rast se ajo nuk vjen.

NENAD RAŠIĆ: Hvala, gospodine predsjedniče!

Poštovani premijeru,

Zamenici premijera,

Ministri,

Dame i gospodo narodni poslanici,

Pre svega, znate i sami da ovaj utisak koji svi steknemo kad se procedure na ovakav način krše, ja uvek imam osećaj kao da nešto pogrešno radimo ili nešto... kao da nešto želimo na brzinu da omalovažimo i instituciju i druge institucije, koje su i unutra i spolja i da samo nešto “sломimo preko kolena”. Ovaj izraz je dosta poznat i kod nas i verovatno ne po prvi put dešava da mi nešto “lomimo preko kolena”.

Tako i danas imamo zakon koji je vrlo bitan i u stvari moramo da brzom procedurom ili u toku dana usvojimo na oba čitanja. Verovatno smo, na žalost, i rekorderi. Mi smo jedina institucija koje sam ja do sada video da je bilo na sednici predsedništva Parlamenta zakon koji je tek dva dana posle toga usvojen na Vladi. To je prvi put da sam video i verovatno ima neke logike.

Šta hoću kao jednu od najosnovnijih stvari da navedem u vezi zakona, to je ja se sećam onog prethodnog, koji je bio pre nekih godinu dana ili godinu i po, koji se pojavio i posle odjednom i nestao. Tim zakonom je bilo predviđeno da treba naći kompaniju koja će prvo i napraviti studiju

izvodljivosti a pored toga i akcioni plan, koji bi trebao i da odredi i na neki način privuče određene zainteresovane same da budu deo procesa.

Mi i posle godinu i po dana nismo imali ništa od toga, ništa se nije desilo i odjednom, preko noći, dolazi nam drugi zakon. Drugi zakon koji takođe, po meni, bez ikakvih konsultacija na bilo kom nivou nije usaglašen. Sada ako mi dozvolite i ako mogu da pitam i gospodina premijera, kako je i sam pomenuo da su bili konsultacija sa svim predstavnicima “Trepče” odnosno sa većinom njih, a vidim da u samom nacrtu zakonu postoji ona treća flotacija, gde se pominje flotisanje ili flotacija između Leposavića i Kopaonika, pa me baš onako živo interesuje, gospodine premijeru, s kim ste se konsultovali i kada je to bilo, jer verovatno da kao jedan od tri segmenata, kao jedno od tri flotacija verovatno je bilo vrlo značajno konsultovati se sa predstavnicima “Trepče”, sa predstavnicima Srba sa severa Kosova, jer verovatno i sam ovaj zakon ili te konsultacije ne bi bile kompletne ako niste imali konsultacije sa Srbima sa severa.

Doduše moram da priznam da što se konsultacija tiče do sada se niste nešto proslavili, jer podsetiću nas skorašnji događaj za demarkaciju, podsetiću na druge mnoge događaje, koji su bili pre toga, gde nije da se niste konsultovali sa nama poslanicima, nego čak što više niste se bavili konsultacijama ni sa vašim najbližim kolegama, kao što je zamenik premijera i dvojice ministara.

Prema tome, vrlo je bitno da mi kažete s kim ste se i kad konsultovali u vezi Flotacije 3 ili onog dela između Leposavića i Kopaonika.

Šta je najtragičnije u ovom slučaju u vezi ovog zakona, to je što će verovatno odnose između Srba i Albanaca da podigne na jedan drugi nivo, ili da kažem, da spusti na jedan potpuno drugi nivo. A znate i vi sami da zakon ne može biti u potpunosti implementiran, ukoliko nemamo konsenzus sa Srbima sa severa. To verovatno znate i vi gospodine premijeru, znaju verovatno i većina mojih kolega, jer ukoliko želite da to bude “mrtvo slovo na papiru”, da ostane samo napisano, doduše ne bi bio prvi zakon koji bi ostao samo napisan a nije sprovodljiv. Ali, ukoliko želite da nešto opipljivo uradite zakonom, morate da konsultujete i da dogovorite načine zajedničke saradnje sa Srbima na severu.

Inače Srbi sa severa imaju dosad i imali su samo jednu alternativu i to je, na žalost, uglavnom ta “Trepča”. Nikad kosovske institucije dosad nisu dale i drugu alternativu Srbima sa severa. Nikad nisu pokazali koji su to benifiti koji oni mogu dobiti ukoliko budu deo kosovskog društva. Baš na protiv, opet mi po starom onom lošem običaju, sve “preko kolena”, sve mora na silu, bez dogovora, bez pokušaja dogovora reći ću, bez pokušaja dogovora. Jer i pasti u dogovoru ili ne dogovoriti se verovatno nije toliko tragično, koliko ne pokušati da iole napraviš dogovor.

Mi i dalje konstanto 17 godina pravimo istu grešku. Zakon je, znate i vi ste i sami i političari smo, pre svega politički motivisan. Ja u ovom momentu kad gledam kao celokupan zakon, kao

jednu celinu, ne vidim kako ovo može biti motiv ekonomsko... za ekonomski razvoj. Pa vi, da bi došlo do ekonomskog razvoja, treba da prevaziđete ogromne političke prepreke, ogromne političke nesuglasice, da bi došlo do iole ekonomskog razvoja. A ne, mi ćemo sad zadnjim, onako obilaznim putem, pa ćemo onda da promovišemo kao ekonomski razvoj a u stvari, znamo svi šta je.

Ja sam, ovaj pobornik onih starih naših izreka, koji u ovom slučaju ima jedna ona koja je vrlo poznata kod nas, u kojoj se kaže “brigo moja pređi na drugoga”. Ako je ovo, što mi ponekad deluje da jeste, namera ovog zakona da vaša briga, briga Vlade, pređe na nekog drugog kao što je Agencija za Privatizaciju ili neki treći organ, koji bi mogao da bude tu značaj, onda mogao bi da vas razumem. Ukoliko to nije strategija “brigo moja pređi na drugoga” onda ovaj zakon će definitivno da uruši i iole malo komunikacije i odnosa, koji imamo sa Srbima na severu Kosova.

Opet kažem uvek imajte na umu da Srbi sa severa nikad nisu dobili alternativu. Jedini njihov mehanizam je bio “Trepča” i institucije koje funkcionišu. Nikad nisu dobili nešto u što bi mogli da izgrađuju poverenje, a ovako ja vam garantujem da se sigurno poverenje ne gradi.

I na kraju, moram da kažem da se slažem sa Visarom, kad je rekao da ovaj zakon nije pravila Vlada Kosova. I ja sam ubeđen da nije, zato što prvi zakon koji vidim da nema gramatičkih grešaka, apsolutno prvi zakon. Eh sad, ko ga je pravio?! Verovatno, gospodin premijer zna! Ali, u svakom slučaju ako i ne bude usvojen zakon, treba ih angažovati za prevod jer ovo je verovatno najbolje tehnički i na srpskom jeziku urađen onako bez ikakvih gramatičkih grešaka. Hvala!

KRYETARI: Atëherë, i përgëzojmë administratën profesionale të Kuvendit, që po bëni punë të jashtëzakonshme. Zonja Donika Kadaaj-Bujupi e ka fjalën. Në ndërkohë, të përgatitet dikush nga pozita...

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Të nderuar deputetë,

Kjo përpjekje e sotme e këtij Kuvendi më e pakta mund të quhet një pafytyrësi, pasi që është një përpjekje që pasurinë më të madhe kombëtare ta dërgoni heshtazi drejt privatizimit, duke pretenduar se po e shpëtoni prej Serbisë. Kjo është një hipokrizi e madhe.

Çdo privatizim që ju e keni bërë në këto vitet e fundit, realisht ka qenë një shpronësim i resurseve, ka qenë një shpunësim i punëtorëve dhe ka qenë një varfërim i qytetarëve.

Nevoja që “Trepça” të shndërrohet në ndërmarrje publike, t’i njihet një status i veçantë dhe në kuptim të interesit të përgjithshëm statusi i saj të jetë special, ka qenë e madhe dhe e kamotshme. Më kujtohet, është pak më shumë se një vit, kur pikërisht në këtë Kuvend ishte sjellë Projektligji

për “Trepçën” dhe aso kohe ishte në përputhje me Ligjin për ndërmarrjet publike. Pas gjashtë-shtatë orësh presion dhe pritje dhe kërkesë të drejtpërdrejtë për Qeverinë e Kosovës nga Vuçiqi, projektligji u tërhoq. Sot nuk po tërhiqet, sepse ka plot mangësi dhe me mangësi të tilla po përpiqeni, madje edhe duke pretenduar që të dilni si patriotë, ta kaloni në dy lexime brenda pak orësh.

Ndërkohë, që ajo që po ndodhë me “Trepçën” është se vit pas viti dhe me kalimin e kohës ju po gjeni zgjidhje të këqija e më të këqija. E keni sjellë në një moment, kur ky gjigant i shpronësuar dhe i eksploatuar në forma të ndryshme herë nga regjimet e huaja e herë nga matrapazët vendorë, që rrjedhimisht kanë pasur përkrahjen e politikës dhe pushtetit, ka mbërrirë që të jetë vetëm disa ditë para likuidimit. Po, tash e dy vjet keni pasur kohë që ligjin ta bëni mirë, ta bëni ashtu siç duhet dhe “Trepça” të shndërrohet në ndërmarrje publike.

Çfarë keni bërë ju? Në formën si është proceduar, duke vënë pikë të rendit të ditës të premtën pas dite, pa studim paraprak të fizibilitetit dhe mungesës së strategjisë, konfirmon faktin se ju sot po përpiqeni të fshihni shumë të panjohura dhe me këtë veprim rrjedhimisht, edhe shumë mangësi. Për shembull, ky ligj i mundëson Qeverisë që të ketë dhe të ndërmarrë vendime radikale të momentit pa e pyetur Kuvendin. E kur e dimë se çfarë Qeveria kemi, atëherë këto vendime nuk do të jenë, as të mira për “Trepçën”, as për punëtorët, as për qytetarët dhe as për Republikën e Kosovës.

Prandaj, e vetmja mënyrë do të jetë nëse pajtohemi dhe fillojmë me amandamentim dhe marrim kohë aq sa na duhet, që ky amandamentim thelbësisht ta ndërrojë këtë projektligj fillestar.

Do të ndalem te dy çështje kryesore, te neni 4, tek aksionarët, rrjedhimisht mospërfshirja e minatorëve, të cilët janë kontribuuesit më të mëdhenj, pra minatorëve të vitit ‘89 e viteve të mëvonshme dhe jo vetëm të punësuarit e tre vjetëve të fundit. Nëse, të gjitha zhvillimet për çlirim dhe kundër regjimit u nisën pikërisht nga këta njerëz, të cilët kontribuan përtej të zakonshmes dhe sakrifikuan gjithçka, në fund t’i lëmë pa asgjë, duke ju uruar për këtë projektligj, është e pandershme dhe është e tepërt.

Emri “Trepça” thuhet se rrjedh nga fjala “tri furra”, të cilat kryesisht punojnë dhe funksionojnë të integruara, funksionojnë unike dhe të pandara. Ndërkaq, projektligji juaj parasheh që këto të jenë njësi të veçanta dhe jo të ndara, rrjedhimisht dhe me arsye pikërisht për shkak të veriut të vendit.

“Trepça” ndërmarrje publike është e vetmja zgjidhje, këtë e kemi thënë disa herë, po e konfirmojmë edhe sot. Në këtë ndërmarrje publike dhe në këtë projektligj duhet të njihet kontributi i gjeneratave dhe këtë do ta procedojmë sot, përmes amendamentit. Nuk do të lejojmë, që “Trepçës” t’i përsëritet fati i KEK-ut, “Ferronikelit” dhe i Aeroportit, sepse jemi të gjithë dëshmitarë se jo shumë kohë më parë, pikërisht në emër të të ashtuquajturave “investimeve të

mëdha”, të cilat edhe sot u përmendën këtu, deputetët votuan gabim dhe këto gabime sot po i paguajnë punëtorët. A nuk protestuan sot 300 prej tyre në shesh, sepse brenda 3 vjetëve nga kompani, për të cilat ju sot po promovoni që do të investojnë dhe do të jenë edhe në “Trepçë”, realisht i larguan nga puna dhe i lanë pa bukë goje. A do të përsëritet i njëjti fat pra edhe për “Trepçën”, duke e shpronësuar fillimisht, duke e shthurur, duke e ndarë në njësi dhe duke e shitur pjesë-pjesë, ashtu siç keni bërë edhe me kompani të tjera, në mënyrë që nganjëherë të përfitonit politikisht, duke bërë koncesione në dëm të vendit për të qëndruar në pushtet e nganjëherë të përfitonit ekonomikisht prej përqindjeve, të cilat i merrni nga këto shitje të pjesshme të njësive dhe privatizimeve të padrejta.

Prandaj, edhe një herë e thërras Kuvendin që të marrë rolin e vet, që ndërmjet këtyre dy leximeve t’i amandamentojmë të gjitha ato nene të cilat e dëmtojnë “Trepçën”, rrjedhimisht popullin dhe qytetarin e Kosovës, dhe vendimmarrjen për “Trepçën” ta kthejmë këtu në Kuvend, sepse vetëm kjo do të jetë vendimmarrja që i takon qytetarëve dhe i takon popullit të Republikës së Kosovës.

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Buja e ka fjalën.

SHUKRI BUJA: I nderuar kryesues,
I nderuar kryeministër,
Të nderuar kolegë deputetë,
Të nderuar qytetarë,

Vërtet sot është një ligj i veçantë, që ka interes shumë të madh edhe për qytetarët e Kosovës dhe për shtetin e Kosovës dhe po gjendemi para këtyre akteve, sepse ky Kuvend nuk ka nxjerr një Ligj i cili është në shumë shtete të perëndimit, si dhe ruan interesin strategjik shtetëror, që ne do të duhej ta nxjerrim një ligj për ndërmarrje me interes strategjik për Kosovën, ku do të hynin normalisht, telekomunikimi, do të hynte transporti ajror e hekurudhor dhe përpunimi dhe nxjerrja e mineraleve, si dhe energjia apo edhe ndonjë fushë tjetër, që është me interes strategjik shtetëror. Në këtë mënyrë nuk do të nxirrim ligje të veçanta për secilën fushë strategjike, siç është “Trepça”.

Deputetët e nderuar, të cilët nuk e njohin ekonominë politike, do të ishte mirë që të mos hyjnë në këto fusha, sepse ekonomia politike e jep shumë qartë se superstruktura e ekonomisë është politika dhe ne si superstrukturë e ekonomisë apo si deputetë e orientojmë zhvillimin ekonomik përmes ligjeve dhe akteve nënligjore. Prandaj, është fushë të cilën e përcakton politika.

Ata të nderuar kolegë të Listës serbe do të duhej gjithmonë ta kenë parasysh dhe të përcaktohen nëse janë për mbrojtjen e interesave të qytetarëve të Kosovës, sepse janë qytetarë të Kosovës dhe nëse janë për mbrojtjen e interesave të qytetarëve të Kosovës, atëherë ky ligj për “Trepçën” është

në interes të qytetarëve të Kosovës e në kuadër të këtyre qytetarëve hyjnë edhe vetë qytetarët serbë, si ajo që po quhet veri, si pjesa tjetër e qytetarëve serbë që janë pjesë e Kosovës.

Gjatë leximit dhe shqyrtimit të këtij ligji, normalisht që e kisha atë ndjenjën e kthimit prapa të kërkesave të vitit '81, që u theksuan këtu, kërkesa apo brohoritje të cilat ishin ndër brohoritjet kryesore të këtyre demonstratave “Trepça është e jona”, “Trepça punon, Beogradi ndërton”. Dhe, këto tregonin se duhet ta ruajmë pasurinë e Kosovës, duhet të jetë pasuri e jona “Trepça”, duhet që këto pasuri të Kosovës të shfrytëzohen dhe gjithsesi, të shfrytëzohen për të mirën e qytetarëve, të cilës i takojnë.

Ajo që më shqetëson, gjithsesi është se bukur me... përditë dalim para aktit të kryer, kur kemi pasur kohë ta shqyrtojmë më mirë këtë ligj dhe shqetësimi im më i madh është ajo që ne do ta aprovojmë këtë ligj, shihet disponimi i deputetëve për aprovimin e këtij ligji dhe çka nëse ekzekutivi i Kosovës hyn, pra detyrohet të hyjë në detyrime për çështjen e “Trepçës” me Beogradin. Unë ju paralajmëroj që të mos hyhet në bisedime, pra të shkelet ky ligj, sepse po na detyroni ta votojmë, normalisht që me dëshirë e votojmë, por po na sillni para këtij akti. Mos hyni në këto bisedime, sepse do të jem, edhe pse ndoshta në moshë të shtyrë, si në vitin '81, në ballë të organizimit të protestave kundër ekzekutivit, i cili do të hyjë në bisedime për pasuritë e Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Hoti e ka fjalën.

ENVER HOTI: Faleminderit, kryesues!

Më në fund erdhi edhe ky projektligj për “Trepçën”. Po them, më në fund, sepse sikur të vinte më herët, ne do të kishim shpëtuar shumë milionë mjete të humbura dhe mjete të pafituara, kështu që sot minierat dhe metalurgjia, e njëkohësisht edhe fabrikat e përpunimit të metalit janë në një gjendje shumë më të keqe se sa që kanë qenë pak më herët.

E keqja vjen prej asaj, sepse është bërë amortizimi i mjeteve dhe teknologjive, si në aspektin fizik ashtu edhe moral, por e gjithë e mira e këtij ligji është se me aprovimin e tij “Trepça” po del prej kthetrave të AKP-së, i cili sipas mendimit tonë e ka shkatërruar krejt industrinë e Kosovës dhe e cila ka qenë aq me rëndësi për mirëqenien e njerëzve të Kosovës.

Problemi kyç është, se ne nuk e kemi studimin e fizibilitetit të “Trepçës”, nuk e kemi inventarizimin e gjendjes së “Trepçës”, nuk e kemi projeksionin e investimeve dhe rezultatet e “Trepçës”, që kishin me dalë pas këtyre investimeve. Ne mendojmë, se pasi “Trepça” po shndërrohet në shoqëri aksionare, patjetër në një kohë të caktuar dhe sa më të shpejtë të dalim me vlerën e “Trepçës”. Shumë me rëndësi është që të dihen asetet e “Trepçës” jashtë Kosovës, po e njëjta rëndësi është që me prerjen e bilancit të gjenden edhe obligimet tjera ndaj “Trepçës”, sepse

nëse merret një mesatare dhjetëvjeçare para vitit 1990, kërkesat e “Trepçës” kanë qenë 70% ndaj të tjerëve, ndërsa obligimet kanë qenë 30% prej tërësisë.

Një moment shumë me rëndësi, mendoj se duhet ta theksojmë, se në periudhën dhjetëvjeçare të vitit 1990-‘99, kur “Trepça” është menaxhuar prej Serbisë dhe Serbia ka qenë nën embargon e OKB-së në atë kohë ka marrë shumë kredi, të cilat fare nuk janë investuar në “Trepçë”, sepse asnjë aset i “Trepçës” nuk është rivitalizuar. Andaj, duhet të kemi kujdes edhe në këtë çështje.

Nisma parimisht e mbështet projektligjin dhe ne do ta japim kontributin tonë nëpërmjet amendamentimit dhe ashtu shfrytëzoj mundësinë që të bëj një propozim, që ndoshta është më mirë t’i lehet më tepër hapësirë në amendamentimin e grupeve parlamentare, të cilat sigurisht se i kanë të gatshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Topalli e ka fjalën.

FATON TOPALLI: Faleminderit, kryesues!

Qeveria e Kosovës kishte përafërsisht dy vjet për të na sjellë një ligj të mirë për “Trepçën”, të cilin do ta trajtonim bashkërisht. Mjerisht, kjo nuk ndodhi! Zoti Kuçi u përpoq t’i thotë disa arsye, por në fakt arsye nuk ka, kjo është një përgjegjësi totale, sa i përket një prej gjiganteve më të mëdha të ekonomisë së Kosovës.

Neni 6, pika 3 e këtij ligji thotë, se duhet të bëhet, apo se ligji është bërë në bazë të një studimi të fizibilitetit, por këtë studim deri më tash nuk e ka parë askush. Nuk dihet cila është pasuria e “Trepçës”, nuk dihet cilat janë asetet dhe këto nuk i thotë as ligji.

Mendoj, se është e rëndësishme të theksohet, që për 45 vjet në “Trepçë” janë përpunuar, respektivisht janë nxjerrë 4 572 tonë argjend, ndërsa për 34 vjet janë nxjerrë 8675 kg ar. Në vitin 1989 “Trepça” kishte këto asete:

Minierat

- kishte minierën e “Trepçës”, pra në Stari Tërg me Flotacionin në Tunel të Parë,
- minierat Kishnica, Artana, Hajvalija, Badovci dhe Flotacioni në Kishnicë, tani aktiv është vetëm Artana.
- minierat Černac, Belo Bërde, Koporič dhe Flotacioni në Leposaviq,

Metalurgjia dhe kimia

- Në metalurgjinë e plumbit, pra kishim shkritoren, rafineritë dhe përpunimin e mbeturinave në Zvečan,
- metalurgjia e zinkut - acidi sulfurik,
- prodhimi i zink-pluhurit dhe zink-oksidit në Mitrovicë,

- industria kimike në bazë të acidit sulfurik në Mitrovicë, pastaj edhe
- prodhimi i ngjyrave dhe llaçeve në Vushtri, tani e privatizuar.

Përpunimi i metaleve

Në fushën e përpunimit të metaleve kemi:

- Industrinë e Akumulatorëve në Mitrovicë,
- Industria e Baterive Industriale (e privatizuar), në Pejë,
- Industria e Baterive nikel-kadmium dhe Baterive litium në Gjilan, gjithashtu e privatizuar,
- Fabrika e Municionit të Gjuetisë në Skenderaj,
- Metaliku, gypat me tegel të zinkuar, tel dhe litar

Pastaj kemi “Teflon”, fundërrinë Gjakovë, gjithashtu e privatizuar.

“Famipa” kishte prodhimin e materialeve për elektrokontakte, prodhimi i thikave, prodhimi i stolive prej arit dhe argjendit, prodhimi i galanterisë, i privatizuar, në Prizren

Te “Llam-kos”-i kemi prodhimin e llamarinës, zinkut dhe fabrikimin, gjithashtu tri herë e privatizuar, në Vushtri,

Kemi pastaj, një varg ndërmarrjesh shërbyese:

- Fabrika e Pajisjeve të Procesit në Mitrovicë
- Energjetika, Bartja dhe Prodhimi i Energjisë Elektrike në Zveçan,
- Ushqimi Shoqëror në Mitrovicë, në veri,
- Transporti në Zveçan,
- Instituti për Plumb dhe Zink në Zveçan,
- Laboratori Qendror në Zveçan,
- Banka Interne Zveçan,
- Trepça-komerc - Import-eksport në Mitrovicë të veriut.

Kemi pastaj edhe një varg ndërmarrjesh të tjera, të cilat janë ndërmarrje, ose objekte të “Trepçës” në veri. Miniera me Flotacionin “Rudnik”, Gornji Milanovac e integruar në “Trepçë” si minierë joaktive.

Në vitin 1963, “Trepça” ka investuar në riorganizimin, modernizimin dhe zgjerimin e kapaciteteve të minierës;

Miniera me flotacion “Lece” në Medvegjë, e integruar gjithashtu në vitin 1963, ku “Trepça” ka investuar;

Miniera me flotacion në Bllagodat - Vranjë, ku “Trepça” gjithashtu ka investuar;

Miniera e baritit në Tisovik, “Trepça” ka investuar në infrastrukturë teknike dhe hulumtime gjeologjike, statusi është për mua i panjohur;

Miniera Podvirovi në Bosllgrad, “Trepça” ka investuar në hulumtime gjeologjike, punë xeherore, hapje të horizonteve hulumtuese dhe prodhim provues;

Fabrika e Akumulatorëve në Sombor;

Pastaj kemi edhe një varg pronash që janë në Beograd, si zyra qendrore në rrugën “Knjaz Mihajlov”;

Shitorja në Zeleni Vjenac;

Depoja Limani i Danubit;

Përfaqësia e industrisë kimike;

Përfaqësia e FAMIP-ës,

Pastaj Qendra teknike komerciale në Nish;

Zyrat, shitoret, servisi dhe depoja, pushimorja e punëtorëve në Canaj, në bregdetin e Malit të Zi dhe pushimore - shtretër në hotel “Vërnjačka Banja” në Serbi.

Pra, këto janë asete të cilat i posedon “Trepça” dhe që nuk janë të vendosura askund në ligj.

Pra, nuk kemi të dhëna sa i përket pasurisë.

Në prill të vitit 2015, Komisioni për Zhvillim Ekonomik kishte kontaktuar specialistë ndërkombëtarë për të shqyrtuar raste studimore lidhur me tipin e menaxhimit dhe llojit të pronësisë për ndërmarrje, sipas tyre, të ngjashme me rastin e “Trepçës”.

Unë nuk po i përmend të gjitha, vetëm dua t’i përmend dy raste, rastin e Polonisë dhe rastin e Turqisë.

Po flas së pari për rastin e Polonisë. Ky rast është shumë i ngjashëm me “Trepçën” dhe besoj që ngjashëm po vepron edhe Qeveria jonë sa i përket “Trepçës”. Në vitin 1991 gjatë procesit që po përgatitej për privatizim ndërmarrja fillimisht iu dha me 100% të aksioneve Thesarit të shtetit.

Për ta menaxhuar sa më mirë zemërimin, fillimisht e kanë privatizuar pjesërisht ndërmarrjen, pra ashtu siç po përpiqet edhe Qeveria jonë dhe Qeveria ka mbajtur pastaj 52.1% të aksioneve, por vite me radhë ka vazhduar copëtimi i ndërmarrjes, ndërsa në vitin 2010 kjo ndërmarrje në Poloni

kishte vetëm 31,8% të aksioneve, gjë që pak a shumë mund të ndodhë edhe me rastin e “Trepçës”.

Rasti tjetër është rasti i Turqisë. Në vitin 1990 Turqia vendos ndërmarrjen e një procesi në proces transformimi, disa miniera i ka mbyllur, disa i ka ndarë dhe i ka privatizuar, kurse disa i ka rishikuar dhe i ka mbajtur në pronësi publike.

Nga katër kompani të privatizuara, vetëm njëra nga to ka qenë e suksesshme, edhe pse për tri kompani të tjera pretendohet se privatizimi ka qenë i suksesshëm, shihet se pas tre vjetëve të privatizimit ato kanë pasur probleme jashtëzakonisht të mëdha.

Pra, privatizimi nuk është garanci që ndërmarrja “Trepça” të jetë një ndërmarrje, me një aset i cili mund të përdoret mirë.

Po mendoj se të gjithë po pajtohem se “Trepça” është aset i rëndësishëm dhe ajo që të gjithë po pajtohem që “Trepça” duhet të hiqet nga administrimi i AKP-së.

Dallimi në mes nesh dhe të tjerëve është në kuptimin se ne mendojmë që “Trepça” duhet të kthehet në ndërmarrje publike, të kontrollohet nga Kuvendi dhe Kuvendi të vendosë për çështjet thelbësore të saj.

KRYESUESI: Faleminderit! Salë, je paraqitur prapë, por ke folur një herë, dy herë s’ka nevojë. Atëherë, fjalën e ka Sala Berisha.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Kam folur në emër të Grupit, dhe në fjalë në emër të grupit t’i kufizon disa qasje individuale, prandaj kam të drejtë edhe me Rregullore të punës së Kuvendit të flas edhe në emrin tim.

Tani më lejoni të them se ligjin që po e shqyrtojmë – gotë gjysmë e zbrazur apo gjysmë e mbushur. Patëm rast të dëgjojmë prej më të ndryshmeve diskutime e fjalime nga konspiracioni deri te rrafshi real.

A është vonë a herët që vjen ky ligj në Kuvend, mendoj për këtë nuk duhet të merremi sot, sepse mendoj që më mirë ka qenë më herët, në vitet e 90-ta Kosova të jetë shtet i pavarur, por nuk ka ndodhur ajo.

Se a është ligji i mirë apo jo, mund të thuhet se ligji është më i mirë i mundshëm. Por paraprakisht, për të gjithë optimistët që mendojnë se ligji zgjidh gjithçka, si me shkop magjik, dëshiroj t’ju përkujtoj se nuk është mirë të ngutemi dhe ta themi këtë, sepse me këtë përfundon gjithçka për dhe rreth “Trepçës”.

Institucioni - Qeveria që do ta menaxhojë, duhet të jetë i përgatitur dhe të përballet me shumë sfida, si për shembull, sfida juridike, sfida e pretendentëve, sfida sociale që ka të bëjë me problemin e ish-punëtorëve të hedhur në rrugë viteve të 90-ta, kategoritë sociale, obligimet financiare, e tjera.

Sfida mjedisore: dhjetëra miliona tona mbetje industriale me specifika ndotëse për mjedisit do të jenë barrë e re për institucionin që e merr përsipër “Trepçën”.

Sfida tekniko-teknologjike: një pjesë e madhe e industrisë minerare, industrisë përpunuese, metalurgjike, kimike, industrisë së baterive e tjera, punojnë me teknologji të stërvjetëruara në shkallë të lartë të amortizimit dhe shkallë të lartë të ndotjes.

Pra, automatikisht lind nevoja e vitalizimit të tyre me teknologji të reja, kompatible me kërkesa të ekonomisë së tregut të lirë, me kërkesa për cilësi më të lartë dhe me kërkesa për industri miqësore me ambientin dhe krejt kjo rezulton me një kërkesë imediate për “Trepçën”, një studim të thellë fizibiliteti për t’i qartësuar dhe vlerësuar sfidat e lartpërmendura, rezervat gjeologjike, kërkesën e tregut e tjera, për çka AKP e ka përzgjedhur një kompani që të merret me këtë studim.

I tërë ky proces e ka një kosto jo të vogël për Qeverinë dhe domosdo ky proces i gjatë dhe i ndërlikuar duhet të përcillet me një strategji të veçantë operacionale dhe me një fushatë aktive transparente, mediale për opinionin dhe situatën që ndodhet aktualisht “Trepça”, që mendoj se më së paku ka nevojë që politika apo e re, opozitare apo qeveritare, e djathtë apo e majtë të garojë për kapjen e bajrakut të “Trepçës” për qëllime të ngushta politike apo për qëllime të mëdha ekonomike.

Tani më lejoni shumë shkurt edhe për një fjalë. Patëm rast të dëgjojmë pozitë e opozitë, etni, përfaqësues, deputetë të ngjyrave të ndryshme, dëshiroj të përkujtoj se vota demokratike me mbështetjen e saj pro pavarësisë së Kosovës është përcaktuar kundër miteve të çfarëdoshme. Sot, vota pro këtij ligji është votë kundër miteve. Mendoj se fatkeq janë ata popuj dhe ata qytetarë që udhëhiqen nga politikanë që qytetarëve të vet u servojnë mite. Janë fatkeq ata qytetarë që manipulohen nga politikëbërës bashkëkombës të një shteti tjetër.

Ne si përfaqësues të qytetarëve të Kosovës duhet të votojmë pro këtij ligji, pro çmitizimit të “Trepçës”, pro zhvillimit, pro çështjeve sociale, pro çështjeve ambientale.

Dhe, jemi te mendimi, pasuritë minerale - mallkim apo bekim. Sot është në dorën tonë që këto pasuri t’i kthejmë në bekim.

Më lejoni të përkujtoj edhe një herë nenin 13 që ka të bëjë përafërsisht me këto që i thashë. Neni 13 mund të zërthehet edhe kështu: se me funksionalizimin e këtij gjiganti, punëtorët pa dallim

etnie, sepse zgafellet nëntokësore - 800 metra nën tokë, me një vështirësi të punës, nuk njohin as gjuhë, as kulturë politike, as etni.

Në zhvillimin e këtij resursi, qytetarët dhe sidomos minatorët, komuniteti do të përfitojë shumë. Qytetarët atje, sidomos në Mitrovicë, do të gjejnë paqen sociale, natyrisht dhe rrjedhimisht – kur ka paqe sociale, ka edhe paqe ndërnjerëzore. Arsyeja është e thjeshtë, funksionalizimi i “Trepçës” do të arrijë t’i bëjë ata - qytetarët e asaj ane me bukë e me strehë, të jetojnë dinjitetshëm, andaj politika e miteve larg duart nga “Trepça”.

Nuk duhet të vazhdojë të sfidohet paqja sociale nga politika dhe ambiciet e sëmura të kujtdo qoftë.

Përfaqësuesit e qytetarëve serbë të Kosovës, qofshin ata në Qeveri ose në Parlament, duhet të marrin guximin dhe të punojnë vërtet për qytetarët nga cilët kanë marrë besim për t’i përfaqësuar interesat e tyre këtu në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Ndërhyrja politike nga shteti tjetër vërtet do t’i shkatërrojë ëndrrat e atyre familjeve që mbahen nga djersa e tyre si punëtorë të “Trepçës”. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Shqipe Pantina e ka fjalën.

SHQIPE PANTINA: Faleminderit, kryesues!

Kualiteti i një ligji se sa i mirë apo sa i dobët është ndikohet edhe prej procesit nëpër të cilin ka kaluar kur është hartuar, por edhe nga procedurat që ndiqen për miratimin e tij.

As procesi dhe as procedurat nëpër të cilat po kalon miratimi i këtij ligji nuk garantojnë se në fund ne do të miratojmë një ligj të mirë, prandaj nuk e kuptoj se cila është ngutja nëpër të cilën ne po kalojmë për ta miratuar këtë ligj.

U tha këtu se janë bërë diskutime, bile në memorandumin që e shpjegon procesin përmenden edhe emra të përveçëm të njerëzve, të cilët qenkan konsultuar apo paskan bërë studime rreth “Trepçës” dhe projektligjit, por asnjëherë, as edhe këta emra që janë përmendur këtu nuk i kanë parë diskutimet e tyre të materializuara në nene të ligjit, prandaj nuk e dimë se edhe sa prej këtyre diskutimeve vërtet në fund të fundit janë përfshirë në draftin final, të cilin Qeveria e ka kaluar dhe ne po e diskutojmë sot.

Dhe, të gjithë ata të cilët kanë qenë të interesuar, sidomos ekspertët vendës, nuk e kanë pasur mundësinë që t’i japin vërejtjet e tyre edhe për materialin të cilin ne sot e kemi para veti, pro disa prej tyre, duke shfrytëzuar mediumet publike, i kanë bërë këto vërejtje.

Unë po e përmend vetëm një nga vërejtjet, të dhëna nga Oda Ekonomike Amerikane, drejtori i të cilës ka shprehur keqardhje që një ligj kaq i rëndësishëm si ky që e rregullon çështjen e një ndërmarrjeje strategjike për zhvillimin ekonomik të vendit vonohet për vite të tëra dhe në fund trajtohet me procedurë të shpejtuar pa diskutim të mirëfilltë publik, posaçërisht me ekspertët e fushës, të cilët do të mund të jepnin kontribut të vlefshëm në aspektet teknike të ligjit.

Pra, nuk ka lënë hapësirë procesi për përfshirjen e njerëzve, të cilët e njohin këtë fushë.

Por, tashmë kjo është vonë për ta diskutuar, sepse ky Kuvend vendosi të mos i marrë parasysh vërejtjet që do të mund t'i kishin ekspertët, duke mos u lënë një hapësirë të tillë atyre.

Por ajo që është më shqetësuese, është edhe vetë komentet e dhëna nga Qeveria. Zakonisht, në secilin projektligj, tek memorandumimi shpjegues neve na është bashkëngjitur një tabelë, ku përfshihen komente të dhëna të gjithë njerëzve që kanë qenë të interesuar dhe në fund, nëse ato komente janë marrë parasysh apo jo.

Në fakt, kjo më shumë e forcon atë që e tha Visar Ymeri më herët se, si duket, nuk është shkruar nga Qeveria, sepse disa nga vërejtjet që i tha zëvendëskryeministri këtu, me siguri po të shqyrtohej si duhet në Qeveri, ato vërejtje do të mund të bëheshin pjesë e projektligjit, sepse ky projektligj është propozim i Qeverisë, apo jo? Dhe nëse as zëvendëskryeministri dhe as ministrat e tjerë nuk e kanë pasur mundësinë që komentet e tyre t'i përfshijnë në projektligj, prapë pra nuk garanton se projektligji është i mirë dhe mbi të gjitha nuk është gjithëpërfshirës.

Por, një gjë tjetër që është edhe më shqetësuese, është analiza buxhetore, gjegjësisht opinioni i Departamentit të buxhetit.

Sipas opinionit të tyre thuhet se legjislacioni nuk ka implikime financiare. Tash, si është e mundshme të flasim për një gjë që po e quajmë gjigant ekonomik, për të cilin Qeveria pretendon të ketë 80% të vlerës dhe të mos ketë asnjë, asnjë implikim të mundshëm buxhetor.

U përmend po ashtu se këtu do të ketë edhe investime. Nëse ka investime, atëherë do të ketë edhe një lloj kostoje, e cila do ta shoqërojë miratimin e këtij projektligji, për të cilin Ministria e Financave po thotë se nuk e ka.

Kryeministri po ashtu përmendi se Qeveria do të gëzojë 80% të devidentes nga "Trepça" për derisa 20% do e gëzojnë punëtorët. Por, si do të përkthehet kjo devidentë pastaj në buxhetin e shtetit? Sepse, sërish në opinionin që e ka dhënë Ministria e Financave thuhet se nuk ka asnjë lloj implikimi buxhetor në këtë projektligj. Dhe, si po flasim ne për një gjigant ekonomik, i cili shpresojmë se do të krijojë vende të reja pune dhe si rrjedhojë do të kontribuojë edhe në buxhetin e shtetit, e Ministria e Financave këtë e sheh si zero implikim buxhetor. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.)

KRYETARI: Faleminderit! Edhe tre deputetë janë paraqitur për fjalë! Profesor, për ju, po e lëmë në fund. Fjalën e ka Albin Kurti!

ALBIN KURTI: Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,
Qytetarë të Republikës së Kosovës,
Qeveria është një institucion publik që duhet të zgjerojë publikën. Ligjet që e ndihmojnë këtë gjë ne si Lëvizje “Vetëvendosje” i përkrahim. Zgjerimi i publikes, përfshirë këtu ndërmarrjet e ndihmon ekonominë, përveçse e përbën atë.

Për shembull, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës sektori publik në vitin 2012 përbënte 39% të bruto produktit vendor, ndërkaq në po atë vit sektori publik në Zvicër u rrit për 10%.

Ndërmarrjet publike a shtetërore në Kosovë janë të pashmangshme edhe për shkak se, thjesht nuk ekzistojnë kompani private të cilat do të ndërmerrenin aktivitete a projekte të shkallës së gjerë e të rrezikut të lartë.

Shtimi i ndërmarrjeve publike është gjithsesi i mirë në parim dhe shpresëdhënës për shoqërinë.

Me lehtësi mund të mendohet që çdo ligj është më mirë se sa “Trepça” t’i mbetet dhomës së veçantë për likuidim, sikurse edhe AKP-së në posedim. Mirëpo, edhe kjo është gjithsesi më keq se sa ta kishim një ligj të veçantë për “Trepçën”, me ç’rast “Trepça” do të ishte ndërmarrje publike e veçantë që lidhet me Kuvendin e Kosovës, madje me shumicën prej 2/3 të deputetëve aty, e jo thjesht vetëm me Qeverinë.

Ky projektligj i paraprinë studimit të fizibilitetit dhe strategjisë së “Trepçës”, që është në kundërshtim me vendimin e Kuvendit - plotësim i Ligjit për ndërmarrjet publike, por në kundërshtim edhe me metodologjinë e përgatitjeve të këtyre dokumenteve.

Përgatitja e këtij projektligji, pa studim paraprak të fizibilitetit dhe strategji, lejon interpretime dhe vendime sipas kërkesës së momentit, e jo sipas ligjit.

Ky projektligj i krijon hapësirë Qeverisë të nxjerrë vendime radikale për “Trepçën” pa e konsultuar Kuvendin.

Neni 2, “Trepça” sh.a., thuhet se përbëhet prej njësisë biznesore, minierat Stan-Tërg, Kishnicë dhe Leposaviq dhe në nenin 6 pika 3, thuhet se “Trepça” SHA, përbëhet prej aseteve të njësisë biznesore.

Mirëpo, ku mbetet asetet e tjera të “Trepçës” në Kosovë dhe jashtë Kosovës? Të mos harrojmë se kur u pati regjistruar kombinati “Trepça” në vitin 1974, atëherë përbëhej prej 20 subjekteve që shtriheshin edhe jashtë Kosovës, si në Plevle të Malit të Zi, në Medvegjë, në Rudnik e Veranje të Serbisë dhe deri në Sombor të Vojvodinës.

Nenet 11, 12 dhe 14, krejt kjo pasuri thuhet që mbetet në mëshirë të studimit të fizibilitetit, të cilën do ta përgatisë për një muaj, për vetëm një muaj, kompania e përzgjedhur, e cila haptazi pranon se kësi lloj studimi nuk ka përgatitur deri më tani.

Në nenin 4 përcaktohen aksionarët. Në mungesë të bursës, e Kosova është larg saj, kjo zgjedhje është një mashtrim i minatorëve. Në shumicën e rasteve, aksionet punëtorëve do t’u mbesin në dorë si letër pa vlerë. Përfshirja e punëtorëve me 3 vjet stazh si aksionarë, punëtorë të pranuar kohët e fundit pa kritere, është e padrejtë. Duhet të rritet stazhi me së paku 10 vjet dhe në vend të tyre të përfshihen në një formë minatorët e pensionuar para kohe.

Për derisa ndërmarrja shoqërore në Kosovën e pasluftës ekziston për t’u privatizuar, edhe ndërmarrja publike nuk ekziston për të qenë e paprivatizueshme. Kjo është arsyeja pse me ligj as nuk mundësohet shpëtimi, e lëre më të garantohet shpëtimi i “Trepçës”.

Me këtë Qeveri, partneriteti publiko privat, kështu i ndan gjërat. Përfitimi ekonomik dhe financiar privatit, kurse kostot mjedisore dhe sociale publikut. Neve na nevojitet zhvillimi i “Trepçës”. Pikërisht zhvillimi e përbën shpëtimin e qëndrueshëm.

Sipas ekspertëve të “Vetëvendosjes” për çështjen e industrisë, me në krye Nazmi Mikullovcin, ashtu siç kemi thënë edhe në alternativën tonë qeverisëse, duhet të bëhet rritja e kapaciteteve prodhuese të “Trepçës”.

Kësisoj, rehabilitimi dhe ristartimi i kapaciteteve për prodhimin e 50 mijë tonë zink elektrolit në vit kërkon këto hapa:

- ngritjen e kapacitetit për finjizim direkt dhe me këtë zgjerim i kapaciteteve në 80 mijë tonë zink elektrolit;
- prodhimi i acidit sulfurik;
- prodhimi i zhivës, indiumit dhe sulfatit të bakrit.

Më tej duhet bërë ndërtimi i kapaciteteve të reja për prodhim të 60 mijë tonë plumb;

- rehabilitimi i stabilimenteve për rafinimin e plumbit dhe prodhimin e argjendit, arit dhe bizmutit, në fazën e dytë edhe prodhimi i legurave speciale, i selenit dhe metaleve të tjera të rralla;

- ndërtimi i stabilimenteve për prodhimin e acidit sulfurik prej gazrave metalurgjike;
- ndërtimi i kapaciteteve për prodhimin e 50 mijë tonë në vit të acidit fosforik;
- prodhimi i plehrave NPK, pra nitrogen-fosfor-potazium, në sasinë prej 100 mijë tonë në vit.

Shteti me pako të ligjeve i stimulon investimet në kapacitete përpunuese dhe garanton furnizim të sigurt me metale për këto kapacitete në kushtet e tregut.

Kosova ka traditë për përpunimin e metaleve me ngjyra, fuqi punëtore të kualifikuar dhe të lirë.

Këto kushte mundësojnë ngritjen e dhjetëra fabrikave, ku do të punësohen dhjetëra mijëra punëtorë dhe ekspertë të profileve të ndryshme.

Shpenzimet qeveritare në Perëndim, historikisht janë rritur, sidomos në një shekull e gjysmë të fundit.

Tash, së fundi, ato u rritën edhe, ta zëmë, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës me 32,8% të bruto produktit vendor në vitin... dhe 41,7% të bruto-produktit vendor në vitin 2011. Ndërsa, në Britani të Madhe nga 36,6%... 48,2% të bruto-produktit vendor.

Pra, jo vetëm si shpenzime qeveritare për mirëqenie sociale, por edhe për investime ekonomike gjithandej në Perëndim, ato janë duke u rritur.

Kjo është posaçërisht e rëndësishme kur kemi parasysh se Mitrovica është toka më e pasur me popullsinë më të varfër. Sipas anketës së UNDP-së nga viti 2010 në jug të Mitrovicës 47,2% të familjeve të ardhurat i kanë më pak se 211 euro në muaj. 40,5% i kanë nga 212 në 500 euro në muaj dhe vetëm 2,6% kanë mbi 500 euro në muaj. Që prej atëherë, gjendja vetëm sa është përkeqësuar.

Natyrisht se jemi për “Trepçën” si pronë e ndërmarrje e Republikës së Kosovës, por çështja është me cilin qëllim? Për shpëtim afatshkurtër e shitje afatgjate, apo për zhvillim të qëndrueshëm?

Ne jemi për të dytën, dhe për këtë gjë nevojitet plan konkret, i qartë dhe i hollësishëm zhvillimor.

Po e ngre çështjen e planti për “Trepçën” sepse, siç thotë një mik imi arkitekt, në Kosovë kemi të drejtën për zbatim të urdhrave, por jo edhe për të planifikuar.

Në vend të demokracisë së zhvillimit, në Kosovën e pasluftës janë instaluar doktrina të stabilitetit dhe privatizimit. Me fjalë të tjera, me këtë Qeveri ne nuk jemi Republikën sovranë por më shumë i ngjajmë një shteti vasalet, i cili kur nuk i bën koncesione Serbisë, është duke iu shitur

një korporate, sepse çdo privatizim në Kosovë është paraprirë nga një privat i interesuar. Blerësi i paraprin privatizimit, e jo anasjelltas. Privatizimi ndodh kur gjendet privati, i cili të blenë ty që po shitesh.

Ata që duan të zhvillojnë “Trepçën”, mund ta bashkojnë Mitrovicën. Qeveria e Kosovës, me ligje për buxhetet në vitet 2014 e 2015 i pati ndarë për “Trepçën” vetëm nga 1,7 milion euro, e po atë në investime kapitale në vitin 2016.

Si mund të ketë të drejtë kjo Qeveri të na flasë për zhvillim të “Trepçës” kur i ndan vetëm 1,7 milion euro në vit për “Trepçën”. Pra, kjo nuk e ka synim fare zhvillimin. Kjo e ka synim shitjen. Shitja nuk është zëvendësim për likuidimin.

As kjo Qeveri s’do që ta zhvillojë “Trepçën” dhe edhe kjo Qeveri tashmë po e lejon zhvillimin e kontrabandës dhe krimit në Mitrovicë. Sërish nuk është Qeveri e zhvillimit të ligjshëm ekonomik, të bazuar në prodhim, por Qeveri e tregtisë së paligjshme që bazohet në importin enorm.

Në nenin 12 thuhet se për të qenë atraktive për investues privatë, vendës dhe të jashtëm, pse jo edhe publikë - janë forma partneriteti publiko privat, investime direkte private, investime të përbashkëta dhe emetimi e shtija e aksioneve. Po, aksionet janë pronësi. Pse jo edhe shitja e obligacioneve të borxhit, dhe pse jo investime publike, para se gjithash dhe mbi të gjitha.

Potenciali kryesor i “Trepçës” janë resurset minerale që vlerësohen mbi 50 milionë tonë. Brezi metalogjenik i “Trepçës” shtrihet në një gjatësi prej 80 kilometrave, dhe përbëhet prej një numri të madh vendburimesh dhe mineralizimeve të tjera përcjellëse.

Në këtë hapësirë shtrihen dhjetëra miniera të plumbit dhe zinkut, të cilat me investime të vogla mund të riaktivizohen ose modernizohen. Pra, as likuidim, as shitje, por zhvillim. Jo doktrina e stabilitetit për privatizim, por ajo e demokracisë për zhvillim dhe në të njëjtën kohë, “Trepça do të duhej që të shndërrohej menjëherë në ndërmarrje publike, e jo në shoqëri aksionare, e zbërthyer dhe e shpërbërë në pjesë të cilat shiten. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Teuta Haxhiu e ka fjalën, le të bëhet gati Mytaher Haskuka.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Pas gjithë kësaj kohe të diskutimeve, ne si Aleancë që në fillim ishim shumë konkretë. Zemërgjerësia juaj kryetar për të diskutuar dhe mundësia e shumë deputetëve këtu, pozitë e opozitë, për të bërë më shumë se sa një propagandë, apo sa për të dalë në media, po harrojmë që po ia pamundësojmë Komisionit i cili do të mbledhet dhe do t’i amendamentojë të gjitha ato amendamente që mund të propozohen nga deputetët.

E dimë që para 10 muajsh, Qeveria përgjurmur e pati sjellë projektligjin, por brenda një kohe të shkurtër u tërhoq, sepse vërtet e kemi pranuar dhe e pranojmë edhe sot që është e përgjurmur dhe është pa vizion, por, megjithatë, sot e kemi një projektligj që ka 8 faqe. Jo më shumë se 8 faqe, për opinionin e kam. I ka 19 nene shumë të shkurtra, që për 10-15 minuta sinqerisht të gjithë deputetët mund ta lexojnë, e nuk besoj që dikush nga deputetët apo nga qytetarët nuk janë të njohur me problemin e “Trepçës”. Mund të bëjmë patriotizëm sa të duam, por Komisioni e ka punën kryesore. Ne thamë që në fillim i kemi 9 propozime, 9 amendamente saktësisht të shkruara, i kemi dorëzuar me kohë dhe kohën e ka Komisioni që duhet t’i amendamentojë ato propozime.

Nëse ne tash që po humbim shumë kohë dhe ju asnjëherë nuk po e menaxhoni mirë seancën, sepse po ja jepni dikujt 20 minuta dhe dikujt nga 2-3 herë fjalën, kjo nuk po i ndihmon as nuk po i kontribuon kësaj shpejtësie që e kemi thënë në fillim, normal që është shumë me nguti dhe me interes, por, megjithatë, është më mirë ta kemi këtë ligj dhe më mirë ta bëjmë një ligj të zbatueshëm dhe në interes të funksionimi të këtij gjiganti.

Sot po flasim e po flasim, e mund të flasim për shumë ndërmarrje të tjera, që janë brengë e të gjithë qytetarëve, por edhe ne si deputetë, ky ligj, edhe një herë po e them, për 10 minuta secili deputet është shumë qartë mund ta lexojë. A ka mangësi brenda ligjit? Po! Normalisht se në 19 nene i kemi 9 propozime, 9 amendamente tona si Aleancë. Prandaj, ja lini kohën Komisionit, jepni propozimet konkrete dhe tregojmë se sa thjesht do t’i kontribuojmë këtij ligji. Andaj, mos bëni edhe ju sa për të thënë “po udhëheqim seancë”, por jepni propozime konkrete. I kemi propozimet, i kemi dërguar dhe punoni daç të punoni, ose lironi vendet!

KRYETARI: Faleminderit! Për 3 minuta, kur do e kryen kështu fjalën. Mytaher Haskuka e ka fjalën dhe më nuk ka diskutues, përveç profesorit Muhamet Mustafa.

MYTAHER HASKUKA: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Kosovës,

“Trepça” ka qenë krenaria e Kosovës dhe është ende, por ajo është po ashtu është shpresa e Kosovës për gjeneratat e ardhshme. Prandaj, ne kur patëm ardhur sot këtu para dite menduam që do të votojmë për këtë projektligj në parim, ngase besonim që na duhet një kohë për amendamentimin e ligjit që ta rregullojmë këtë ligj ashtu siç duhet, që të jetë shpresa e Kosovës, e jo shpresa e disa privatistëve, të cilët do ta privatizojnë atë.

Por, kjo shpejtësi marramendëse, e cila po bëhet me këtë projektligj, unë s’po e kuptoj, domethënë cili është problemi, kujt po i frikësohemi dhe pse po shikojmë me këtë procedurë? Mund që brenda një jave ta analizojmë ligjin mirë, në mënyrë të hollësishme, dhe javën e

ardhshme t'i shikojmë pjesët ku mund të amendamentohet dhe ku mund të rregullohet ligji dhe ta shpëtojmë "Trepçën" që të vazhdojë të jetë shpresa e Kosovës në të ardhmen.

Po, shumë interesant me këtë Kuvend, edhe pse po e quajmë Kuvendi i Kosovës, ku ne duhet t'i analizojmë dhe t'i diskutojmë ligjet, neve gjithmonë ligjet më të rëndësishme po na jepen në 24 orët e fundit, ashtu që të mos kemi kohë as t'i lexojmë ato, e as t'i shohim se cilat janë pikat ose problemet e tyre, ose çka duhet të rregullojmë në ato ligje.

Unë këtu vetëm dua të përmend diçka, meqë i shikova disa statistika. Kongresit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës i duhen mesatarisht diku rreth 263 ditë që ta votojë një projektligji, i cili vjen në fillim në Kongres dhe për të dalë që të votohet para kongresistëve i merr 263 ditë. Pra, çdo ligj diskutohet ose lexohet së paku 263 ditë nga kongresistët amerikanë.

Parlamenti Evropian e ka mesataren 182 ditë, ose deputetëve të Parlamentit Evropian, që ta analizojnë ligjin, të diskutojnë me njerëz të cilët i prek ligji dhe në fund që të vendosin për të.

Ndërsa neve deputetëve të Republikës së Kosovës zakonisht gjithmonë po na jepen më pak se 24 orë për të vendosur për gjëra shumë të rëndësishme të Kosovës.

E, tërë kohën po flasim për integritet evropian, euroatlantike e kështu me radhë. Prandaj, nëse besoni me të vërtetë në këto, atëherë duhet shikuar edhe praktikën e tyre demokratike, e jo vetëm të flasim në aspektin reklamues.

T'i përkujtoj deputetët tjerë të cilët janë këtu që Kosova është republikë, pra shtet ku pushteti suprem është i qytetarëve dhe i popullit, i cili ushtrohet me përfaqësuesit e zgjedhur, pra me deputetët - pra Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Nëse i shikojmë edhe pasuritë e tjera të Kosovës, shumica e tyre kanë qenë të krijuara nga punëtorët, nga fermerët, e me procesin e dëmshëm nëpërmjet AKP-së faktikisht u tjetërsuan dhe ata që patën kontribuar me aq mund në krijimin e këtyre fabrikave dhe ndërmarrjeve faktikisht përfituan shumë pak.

Ne për çdo ditë në Komisionin për të Drejtat e Njeriut marrim ankesa nga punëtorët lidhur me mosrealizimin e të drejtave të tyre në Qeveri dhe nga privatizimi.

Së fundi diskutuam me punëtorët e Sharr-Cemit, të cilët faktikisht vuajnë nga sëmundjet e ndryshme, e që i kanë marrë nga azbesti e nuk kanë mundur ta realizojnë as 20% e Fondit nga Privatizimi as 10 vjet pas.

Për një proces ku ky 20% nuk është realizuar nga shumica e punëtorëve të fabrikave dhe të ndërmarrjeve të cilat janë privatizuar deri më tani, ne nuk mund të besojmë që edhe “Trepça” nuk do të bëhet njëjtë si fabrikat dhe ndërmarrjet tjera që janë bërë deri më tani.

Unë besoj që edhe të gjithë deputetët me të vërtetë ia duan të mirën “Trepçës” dhe besojnë që “Trepça” duhet të jetë shpresa e Kosovës që ta amendamentojmë nenin 4, me të cilin bëjmë faktikisht që Kuvendi i Kosovës të jetë ajo pronar i 80% dhe nenin 12, i cili faktikisht garanton në njëfarë mënyrë privatizimin e “Trepçës” ta heqim nga ky ligj dhe ashtu që “Trepça” me të vërtetë të shpëtohet nga likuidimi po në të njëjtën kohë edhe të vazhdojë të jetë shpresa e Kosovës për zhvillim. Faleminderit!

KRYETARI: Muhamet Mustafa e ka fjalën dhe jemi para votimit.

MUHAMET MUSTAFA: Unë vetëm dua të theksoj që diskutimi i ka verifikuar disa kërkesa të Komisionit lidhur me amendamentimin eventual për çështjet që i kemi përmendur aty dhe sigurisht ne do të punojmë që t’i përbashkojmë amendamentet, në mënyrë që edhe teksti të jetë më konciz edhe t’i përbashkojë deputetët në këto çështje ku po shihet që kemi një pajtueshmëri.

Meqenëse jemi para opinionit dhe po përmenden studimet e gjetjet, opinionin duhet të jetë mirë i informuar dhe po them që sipas studimeve investimet në partneritet me sektorin privat dhe pas këtyre investimeve në krahasim me mesataren shtatëvjeçare para këtyre partneriteteve dhe pas partneriteteve në Turqi janë rritur efektet - alumini katër herë, bakri tetë herë, argjendi nëntë herë, kurse Boraksi që ka mbetur ndërmarrje publike vetëm 2,5 herë. Prandaj, opinionin duhet të jetë i informuar mirë dhe kontribut i ekspertëve duhet të lexohet mirë. Kjo është e para.

E dyta, studimi i fizibilitetit do të punohet për katër muaj, e jo për një muaj. Kjo është kontrata. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! E kemi konsumuar debatin në mënyrën më demokratike të mundshme, shembull për demokracinë. Aktualisht jemi në pjesën kur përfaqësuesi i Qeverisë, në qoftë se e do fjalën, mund ta marrë, kryeministri a zëvendëskryeministri.

Atëherë shkojmë te votimi.

Të nderuar deputetë,

Në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për miratimin në parim të Projektligjit për “Trepçën”. Ta keni parasysh aktvendimin e Gjykatës Kushtetuese, mëditjet nuk jepen për ata që nuk votojnë.

Atëherë lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, e votojmë Ligjin për “Trepçën”.

Atëherë, 92 deputetë rekord kanë votuar, prej tyre 80 janë për, 12 abstenim, do të thotë urime për leximin e parë!

(Duartrokitje)

Tani 92, ata që s'e kanë prekur fare sustën i humbin mëditjet. Edhe Melihate Tërmmkolli ka votuar për, të keni parasysh 93, edhe Luljeta Veselaj Gutaj për 94, domethënë 82 kanë votuar për. Janë dy vota me dorë. Në qoftë se keni kontestime deputetë të nderuar, pot ta kemi parasysh.

Atëherë konstatoj se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për “Trepçën”.

Ngarkohen Komisioni FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri dhe komisionet e përhershme që në pajtim me vendimin e seancës së sotme ta shqyrtojnë Projektligjin për “Trepçën” dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime për seancën plenare që do të mbahet më 7 tetor, në orën 20:30.

Ndërkohë e kemi një kërkesë nga 45 deputetë, të nderuar kolegë deputetë,

Gëzim Kelmendi e ka iniciuar një seancë të jashtëzakonshme, të cilën mund ta mbajmë sot, tash. Ka të bëjë me arrestimin e kolonelit të Policisë së Kosovës, zotit Nehat Thaçi.

Në orën 20:30 është seanca e re plenare.

I nderuar koleg Gëzim, do të procedojmë menjëherë me seancë. Keni të drejtë, shumë shpejt do të kemi seancë të veçantë për rastin, gjithsesi. Mirupafshim!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*